

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN

FAKULTETI I EDUKIMIT

MËSIMDHËNIE E GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE

PROGRAMI MASTER



TEMË E MASTERIT

“Liria dhe robëria në poezinë nga burgu, si ide poetike dhe si ligjërim/ Një interpretim për nxënësit e shkollave të mesme të larta.”

Mentor:

Prof. Dr. Bajram Kosumi

Kandidatja:

Mirjeta Hyseni

Gjilan, 2025

Nëse do të më pyesnin: *Si përjetohet poezia?*

Do t'ju përgjigjesha: *Lexoje një poezi nga burgu!*

Mirjeta Hyseni

Deklarata e Autorësisë

Unë, Mirjeta Hyseni, deklaroj se ky punim i Masterit me titull “Liria dhe robëria në poezinë nga burgu, - si ide poetike dhe si ligjërim/ Një interpretim për nxënësit e shkollave të mesme” nuk është prezantuar më parë.

Përmbajtja e këtij punimi është e realizuar në tërësi nga unë, deklaroj se të gjitha frazat, fjalitë dhe mendimet e autorëve të ndryshëm të cilat janë përdorur në këtë punim janë të cituara me referenca të drejtpërdrejta në faqe të caktuara.

Falënderime

Me përfundimin e këtij rrugëtimi akademik në studimet pasuniversitare, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë ndaj gjithë atyre që më kanë mbështetur gjatë kësaj periudhe të rëndësishme të jetës sime.

Së pari, falënderoj mentorin tim, Prof. Dr. Bajram Kosumi, për përkrahjen e vazhdueshme dhe motivimin që më ka dhënë për të ecur përpara, për udhëzimet e tij profesionale. Kontributi i tij ka qenë vendimtar në formimin tim akademik.

Një falënderim i sinqertë i takon familjes sime, për durimin, dashurinë dhe mbështetjen pa kushte në çdo hap të këtij rrugëtimi. Pa ta, kjo arritje nuk do të ishte e mundur.

Po ashtu, falënderoj kolegët dhe miqtë që më kanë inkurajuar dhe ndarë me mua eksperiencat dhe sfidat e këtij rrugëtimi.

“Ne jemi pikërisht ajo që bëjmë vazhdimisht. Prandaj, përsosmëria nuk është një veprim, por një zakon.” – Aristoteli

Përmbajtja

TEMË E MASTERIT	1
Deklarata e Autorësisë.....	3
Falënderime	4
Abstrakt	7
The abstract.....	8
Hyrje.....	9
Qëllimi i studimit.....	10
Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat	10
Metodologjia dhe metodat e studimit.....	11
Literatura e shqyrtuar.....	12
Kapitulli I.....	14
1.1 Shkrimi i letërsisë nëpër burgje.....	14
1.2 Poezia, zhanër dominant i letërsisë nga burgu	16
1.3 Përjetimi i letërsisë (poezisë) së burgut nga lexuesi	18
Kapitulli II	24
2.1 Liria dhe robëria në poezinë nga burgu.....	24
2.2 Poezia dhe interpretimi.....	25
2.2.1 Arshi Pipa	27
2.2.2 Kasëm Trebeshina	30
2.2.3 Ismail Syla	33
2.2.4 Bajram Kosumi.....	37
2.2.5 Avdush Canaj.....	41
2.2.6 Visar Zhiti	44
2.2.7 Merxhan Avdyli	51
2.2.8 Hydajet Hyseni.....	55
2.2.9 Rasim Selmanaj	58
2.2.10 Besim Zymberi.....	60
Kapitulli III	62
3. Shenja në poezitë e burgut.....	62

3.1 Intertekstualiteti në poezinë nga burgu	63
Përfundim	68
Bibliografia dhe literatura	69

Abstrakt

Ky punim ofron një hulumtim dhe interpretim të mundshëm për letërsinë e krijuar në burg, poezinë e shkruar nga autorët e kësaj letërsie. Ndonëse, kjo letërsi ende nuk është trajtuar aq sa duhet, përmes këtij punimi jam munduar t'i ofrojë lexuesit rëndësinë, vlerat, risinë që ajo posedon, ndaj edhe është i rëndësishëm ky studim. Duke e ditur se poezia është shkruar më së shumti në burgje në krahasim me zhanret e tjera letrare, objekt studimi në këtë punim është poezia, idetë poetike me të cilat shprehet, pikërisht dy nga ato më të pranishmet, liria dhe robëria. Në studim kam përzgjedhur disa nga poezitë e autorëve të burgut me këtë tematikë, duke i interpretuar ato dhe zbërthyer figurat stilistike me të cilat ndërtohen, e kjo është arritur duke i shfrytëzuar edhe burimet e konsiderueshme letrare. Për t'i realizuar qëllimet dhe objektivat e këtij punimi, do të përdorim disa metoda të caktuara si: metoda e analizës së përmbajtjes (analitike), deskriptive, stilistike, krahasimtare (komparative).

Fjalët çelës: poezia, burgu, liria, robëria, interpretimi.

The abstract

This paper offers a possible research and interpretation of the literature created in prison, the poetry written by the authors of this literature. Although this literature has not yet been treated sufficiently, through this paper I have tried to offer the reader the importance, values, and novelty that it possesses, which is why this study is important. Knowing that poetry is written mostly in prisons compared to other literary genres, the object of study in this paper is poetry, the poetic ideas with which it is expressed, precisely two of the most present ones, freedom and captivity. In the study, I have selected some of the poems of prison authors with this theme, interpreting them and analyzing the stylistic figures with which they are constructed, and this has been achieved by also utilizing considerable literary sources. To achieve the goals and objectives of this paper, we will use certain methods such as: content analysis (analytical), descriptive, stylistic, and comparative methods.

Keywords: poetry, prison, freedom, captivity, interpretation.

Hyrje

Letërsia nga burgu në shqip është shkruar pothuajse gjatë tërë shekullit XX dhe ka një histori të veçantë komunikimi me lexuesin, për shkak të botimit të saj shumë të vonshëm në shumicën e rasteve edhe dhjetë, pesëmbëdhjetë apo njëzet vjet pas shkrimit. Sipas studiuesve kjo letërsi paraqet një vlerë të madhe për letërsinë shqipe sidomos për temat dhe motivet që sjell në letërsinë shqipe, por edhe për figurat e ligjërimin poetik.. Letërsia nga burgu përbën një kapitull të veçantë në letërsinë shqipe, edhe kur kemi parasysh kohën dhe rrethanat në të cilat u krijua. Kur flasim për zhanret e kësaj letërsie, kurorën i vëmë poezisë sepse ajo është pikërisht më mbizotëruesja në këtë periudhë shkrimi. Leximi dhe interpretimi i kësaj letërsie, veçanërisht i poezisë është i duhur për nxënësit, e sidomos për ata të shkollave të mesme të larta. Kjo për arsye se kjo poezi nxit te ata ide dhe përjetime artistike të lloj-llojshme për jetën, për situatat radikale ekzistenciale, si janë burgu, dhuna, liria, robëria, vdekja, sakrifica, heroizmi, vetmia etj.

Në fokus të këtij punimi master do ta kemi poezinë nga burgu, si zhanër letrar. Brenda elementeve të poezisë do të trajtojmë, përkatësisht dy tema të mëdha të poezisë nga burgu, atë të lirisë dhe të robërisë. Duke analizuar këto dy tema, të cilat janë prezente në shumicën e këtyre poezive, ne do të kuptojmë më thellë e më shumë se cila është marrëdhënia në trekëndëshin njeri (subjekt)-liri (koncept)-robëri (burg, dënim, shtypje). Kjo poezi hap horizonte të reja në marrëdhëniet njerëzore brenda këtij trekëndëshi. Në analizën e dy temave të mëdha të kësaj letërsie do të fokusohemi në dy elemente poetike: 1. Te idetë dhe kuptimet poetike, pra te tematika dhe mesazhi që përcjellin këto poezi te lexuesi: 2. Te ligjërimi poetik në të cilin ekzistojnë këto poezi, e kjo nënkupton një analizë më të thellë të gjuhës poetike, të figurave stilistike.

Nëpërmjet këtij studimi synohet të jepet një kontribut në lëndën e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe, të ndihmohet nxënësi (lexuesi) të kuptojë më mirë pëmbajtjen e poezisë dhe letërsisë nga burgu.

Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është të hulumtojë, nëpër skutat më të thella të poezisë nga burgu, për të kuptuar disa prej motiveve që e shtyjnë njeriun drejt sakrificës për idealin e lirisë, mënyren e realizimit të këtyre motiveve dhe interpretimin e mundshëm të kësaj poezie në lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe në arsimin e mesëm të lartë.

Burgu, një mbyllje fizike por një hapje mendore (shpirtërore). Autorët e kësaj letërsie kanë shkruar dhe i ruajtën poezitë e tyre për botim. Kjo dëshmon një dashuri, një zhvillim tjetër mbi letërsinë tonë. Qëllimet dhe objektivat e këtij punimi lidhen me këtë poezi, elementet e saj të përbashkëta dhe të dallueshme në ide e ligjërim. Poezitë janë shkruar për të shprehur mendimet, ndjenjat, vështirësitë me të cilat ata përballeshin çdo ditë në burg. Poezia si formë letrare, si një mjet për mësimdhënie shërben për nxënësit në mësimnxënie, idetë poetike si liria e robëria ndikojnë në ngritjen e ndjenjës emocionale, dashurinë ndaj atdheut, duke përcjellur kështu mesazhe të rëndësishme për ta.

Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat

Pyetjet hulumtuese që ky punim kërkon t'u përgjigjet kanë të bëjnë me dy idetë e mëdha poetike të poezisë nga burgu, lirinë dhe robërinë, njohjen, kuptimin dhe vështirësitë që kanë nxënësit kur analizojnë këto poezi.

Disa pyetje hulumtuese janë kështu:

1. Cilat janë temat më të rëndësishme në poezinë nga burgu dhe cili është vendi i temës së lirisë e të robërisë në këtë poezi?
2. A është liria dhe robëria në këtë poezi tradicionale apo sjell ide poetike të reja?
3. Me çfarë motivesh realizohen këto tema?
4. Me çfarë figurash realizohen këto tema?

5. Si realizohet ligjërimi në këto tema: është ligjërim i pastër poetik apo ndërthuret edhe me ligjërime të tjera jopoetike (si p.sh. ligjërimi propagandistik, politik, nacionalist etj.)?
6. Si mund të interpretohen këto poezi dhe këto motive për nxënësit e shkollave të mesme të larta?
7. Si mund të përdoren motivet dhe figurat e tilla në edukimin estetik e humanist të nxënësve të shkollave të mesme të larta?
8. Cilat janë mesazhet që përcjellin këto poezi?

Hipotezat që ky punim ka ngritur për t'i studiuar janë:

- H1:** Edhe pse liria dhe robëria janë tema të njohura për letërsinë shqipe, mënyra se si realizohen nëpër motive dhe në figura stilistike e në ligjërim në poezinë nga burgu, sjellin risi në poezinë shqipe.
- H2:** Përmes diskutimit për temën e lirisë dhe robërisë në poezinë nga burgu mund të ndikohet në vetëdijen estetike, humaniste e shoqërore të nxënësit e shkollave të mesme të larta.
- H3:** Poezia me tematikë lirinë dhe robërinë duhet të përfshihet në libra shkollorë.

Metodologjia dhe metodat e studimit

Për këtë studim, fillimisht duhet bërë një analizë rreth temës duke përdorur literaturën bazë dhe atë ndihmëse (kritikën). Kjo nënkupton leximin e poezive të autorëve të burgut- analizën dhe interpretimin e tyre. Pastaj me ndihmën e literaturës teorike fuqizojmë mendimet dhe pohimet tona. Kombinimi i këtyre dyjave, në këtë rast do të na mundësojë prezantimin e punimit tonë, përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave të hulumtimit.

Nga metodat e hulumtimit do të përdor disa metoda cilësore:

- **metodën e analizës së përmbajtjes**, e cila do të më shërbejë për të identifikuar temat kyqe të poezisë nga burgu, motivet, mesazhet etj.;
- **metodën e analizës stilistike**, e cila do të më shërbejë për të analizuar ligjërimin, figurat stilistike, të poezisë etj.;

- **metodën e sintezës**, e cila do të më shërbejë për të sjellë përfundime rezymuese dhe interpretuese për poezi të veçanta se si ato ndikojnë te nxënësit e shkollave të mesme të larta dhe se si mund të interpretohen për një ndikim në vetëdijen estetike, humaniste e sociale te nxënësit.
- **metoda krahasimtare (komparative)**, e cila do të më shërbejë për të krahasuar shprehjet e veçanta dhe të përbashkëta të poezive.

Këto metoda hulumtimi do të më ndihmojnë në përkufizimin e dy temave më të mëdha poetike në poezinë nga burgu: liria dhe robëria (temë letrare), mënyrën e shfaqjes së tyre në tekstin poetik e në ligjërim dhe, po ashtu mundësinë e interpretimit për nxënës të shkollave të mesme të larta (didaktikë).

Literatura e shqyrtuar

“ Letërsia u dënua, fut në burg, dhe si kundërpërgjigje, u krijua letërsia e burgut ...Ç’u shkruajt në burg, s’i zëvendëson asgjë e as mund të përsëriten e tjetërsohen e as të ribëhen. Kanë brenda ato copëza kohe të rënda të të shkruarit fshehurazi, atë kohë dhe ato fjalë burgu që ndrydhnin atë frikë dhe atë liri të brendshme, atë ankth dhe atë vdekje, atë shpresë dhe atë agim, atë psherëtimë dhe atë armiqësi, ato plagë dhe atë marrëzi, atë gjak dhe atë ëndërr, atë zgjim dhe atë dobësi, atë metaforë dhe ato zhgënjime, atë emocion fatal dhe atë frymëzim demoniak, etj, se s’kish si të ishte ndryshe. Kaq. S’duhet gjë më.”¹

“ Çështja e parë e rëndësishme në këtë letërsi, nga aspekti zhanror, është pikërisht dominimi i madh i poezisë dhe i epistolarit si gjini letrare. Pavarësisht arsyeve pse ndodhë kjo, nga aspekti letrar kjo determinon edhe vlerat më të larta të kjo gjini. Sidomos poezia nga burgu bartë në vete

¹ Visar Zhiti, *Kartela të realizmit të dënuar dhe panteoni i nëndheshëm- sprovë pas burgut për të tjerët dhe veten*, Uegen, Tiranë, 2020, f.401.

një madhështi tematike, ligjërimore dhe figurative, mbi të gjitha, është lirikë origjinale, moderne dhe njëkohësisht kryengritëse.”²

“ Kjo lirikë është krijuar prej poetëve të cilët kanë pasur, kush më shumë e kush më pak, të njëjtin fat jetësor kanë burguar. Ky fakt jetësor ka paracaktuar edhe disa rrethana të njëjta të komunikimit të tyre me jetën, të literaturës së lexuar, të diskutimit të çështjeve të njëjta, po edhe të disa situatave jetësore të njëjta që kanë ndikuar në përjetimin dhe krijimin e disa ndjenjave përafërsisht të njëjta, si p.sh përballimi i dhunës si shfaqje e skajshme politike dhe antihumane, vetë ballafaqimi me këtë antihumanizëm, malli për atdheun e për familjen, dashuria në largësi ndaj femrës etj.”³

“ Lexuesi i kësaj poezie është herë një person, herë një strukturë e shoqërisë, herë familje apo rreth shokësh e miqsh, herë është një popull i tërë, e herë është kundërshtari, qoftë një person apo një kundërshtar i njëjtësuar. Po vetë fakti që shpesh kjo lirikë krijohet në forma të ndryshme zhanrore vetëm e vetëm për të arritur të lexuesi dhe komunikuar me të, ligjërimi poetik shndërrohet në bisedor dhe ky ligjërëm bëhet strukturë ndërtimore e saj, është një tregues i fuqishëm se kjo poezi krijohet si refuzim i burgut, i cili pamundëson komunikimin dhe imponon shurdhimin.”⁴

“ Poezia është një rrugë krejt e veçantë për të përdorur gjuhën ashtu që fjala të thotë më shumë sesa fjala në vete dhe që fjalët e vëna në lidhje të shkëlqyer poetike të thonë shumë më tepër sa që mund të thonë ato në përdorim të zakonshëm veç e veç. Poezia del se transmeton dhe komunikon një eksperiencë karakteristike të ndarë në shumë pjesë të mendimit, të cilat përdoren si pjesë të asaj eksperience. Poezia është një lidhje fjalësh me shprehësi dhe shqiptim ritmik, ndërsa përmbajtja e atyre fjalëve të lidhura sipas ritmit, kuptimit dhe shprehësisë, shkakton emocione të thella të lexuesi.”⁵

² Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.112

³ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.113.

⁴ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.113

⁵ Zejnullah Rrahmani, *Teoria e letërsisë, (botim i dytë i plotësuar)*, Faik Konica, Prishtinë, 2008, f.166

Kapitulli I

1.1 Shkrimi i letërsisë nëpër burgje

“ Të shkruarit është sakrificë. Edhe kënaqësi, Edhe atje ashtu ishte.

Por e rrezikshme.

Aq më mirë. Rreziku është kudo...

*Por tjetër. Prandaj ka tjetër vlerë letërsia burgu, kjo nuk ka si harrohet.”*⁶

Letërsia është një proces, i cili zhvillohet prej tri elementeve; fillon nga autori (krijuesi) vazhdon me shkrimin (tekstin) e pastaj përfundon tek lexuesi. Por, si zhvillohej ky proces në burg? Në kushte të burgut është e vështirë të jetohet e lëre më të shkruhet, por letërsia është shprehje, e autorët e letërsisë nga burgu çlironin shpirtin nga trupi i robëruar. Ata shkruanin në kushte e rrethana të ndryshme, gjithherë të rënda, mbase shkrimi mund t’ua sillte edhe vdekjen.

Për mënyren e zhvillimit të letërsisë në burg, Bajram Kosumi në librin e tij “Letërsia nga bugu” shkruan:

”Ata janë nxitur në rradhë të parë nga rrethanat në të cilat kanë jetuar: nuk kanë pasur gjithherë laps apo fletore, nuk ka qenë e lejuar të ulen e të shkruajnë, edhe kur kanë shkruar tekstet ua kanë zhdukur rojat e burgut, ose janë ridënuar për shkrimet e tyre etj. Ata, duke baritur qelive të ngushta e të nëndheshme kanë menduar disa vargje, duke pritur me radhë numërimin kanë menduar disa vargje të tjera, duke u transferuar nga njëri te burgu tjetër kanë menduar disa vargje të tjera dhe, këto vargje është dashur të mësohen përmendësh, në mënyrë që në rastin e parë të dhënë, mbas një dite, mbas një jave, mbas një muaji, ndoshta kur është liruar nga burgu,

⁶ Visar Zhiti, *Kartela të realizmit të dënuar dhe panteoni i nëndheshëm- sprovë pas burgut për të tjerët dhe veten*, Uegen, Tiranë, 2020, f.402.

t'i hedhë në letër. Në këso rrethanash ka qenë i pamundur, ta zëmë, shkrimi i romanit, prandaj krijuesit kanë mundur ta krijojnë vetëm lirikën.”⁷

“Në burgjet jugosllave/serbe dhe shqiptare nuk lejohej shkrimi i letërsisë apo çfarëdo artikulimi tjetër intelektual. Në qelitë- vetmi të burgut të Nishit, përveç rrobave të trupit dhe mjeteve higjienike, asgjë tjetër nuk i lejohej të burgosurit. Në situatat e tjera të burgut, si izolimi apo edhe në pavijon lejohej lapsi dhe fletorja, por jo shkrimi si aktivitet intelektual. Të burgosurit shpiknin forma e metoda të ndryshme për shkrimin. Shkruanin në fletore, në letrat e kutive të cigareve, në letrat familjare etj”.⁸

Brenda burgut po krijohej një letërsi dhe vazhdimisht kërkohej një mënyrë për ta ruajtur atë, sepse çdo herë ekzistonte, ajo, frika e zhdukjes së saj. Një nga mënyrat ishte shkrimi i letrave. Poezinë, nuk e shkruanin si poezi por si një formë tekstuale, në një letër dërguar familjes:

“Vetëm letrat familjare nuk i zhbënin rregullisht. Nga një herë po, veç jo rregullisht. Kështu, poetët e burgosur gjetën një formë të arkivimit pak më të sigurt: bashkë me letrat familjare fusnin edhe tekste poetike, të improvizuara si letra familjare. Këtu ndihmonte fakti që poetët shqiptarë vuanin burgun në hapësira jo shqipfolëse, pasi gardianët shikonin vetëm formën e tekstit, kur shihnin se ajo dukej si një letër familjare, e cila ka kaluar nëpër censure, e linin, nuk e zhduknin, sepse jot ë gjitha letrat familjare e kishin atë vulën e zezë, ku shkruante “cenzuriano”.⁹

Për krijimin dhe arkivimin e letërsisë nga burgu, shkruan edhe Visar Zhiti. Ja si shprehet ai:

“Aty t'i lëmë thasët? Cilët thasë? Të burgut...”

Pikërisht në thasë të vjetër të arnuar; me njolla dheu e gjaku, ku të dënuarit dikur... ou, na çove larg në rendin skllavopronar; jo, jo, është pothuajse tani, janë gjallë shumë nga ata ish të burgosur, që në ato thasë, ku mbanin veshjet e tyre, që mund t'u kishin mbetur edhe prej të vranëve, mes gjërave që haheshin, që i ruanin për ndonjë ditë urie edhe më të keqe, futnin copa

⁷ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu-kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve-Shkup, 2020, f.58.

⁸ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.60.

⁹ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe-botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020. f.61.

letre, fletore e blloqe të shkruara, të tyret, të ndonjë bashkëvuajtësi, ia ruanin e kishin amanet, ndonjëherë edhe pa e ditur se të kujt ishin ato shkrime, që mezi lexoheshin, qenë ronitur, edhe minjtë kishin brejtur ç’kishin mundur; censura e tyre parake a e mëpastajshme, e brendshme, njëlloj ishte, aq më mirë, se policia, po t’i kapte, s’do të kuptonin edhe aq censored e shtetit.

Po të burgosurit dinin s’i ti fshihnin shkrimet...

Ishte e pabesueshme, ndoshta edhe vetë nga ata që i kishin mbushur ato fletë në fshehtësi, se në thasët e burgut kishin të rrasur letërsi të ardhme, nga ajo e përvuajtura, e ndershmja, e shpëtuar nga kontrollet shfarosëse, nga djegiet, nga realizmi socialist.”¹⁰

“ Letërsi burgu është vetëm ajo letërsi e pakët që u shkrua brenda në burg nga të burgosur. Që mbijetoi, u arrit të nxirret nga burgu dhe është në letër, dëshmi.”¹¹

“ Botimi i deritashëm i pjesës më të madhe të kësaj letërsie jep prova të forta se kjo letërsi jo vetëm që funksionon si e tillë, por është pranuar mirë nga lexuesi dhe e pasuron mjaft shumë historinë e letërsisë shqiptare.”¹²

“Letërsia e burgjeve është dhe ajo që lëvizi gjithë letërsinë e sotme shqipe.”¹³ “ Pa këtë letërsi, letërsia shqipe do të ishte e mangët dhe më e varfër.”¹⁴

1.2 Poezia, zhanër dominant i letërsisë nga burgu

¹⁰ Visar Zhiti, *Kartela të realizmit të dënuar dhe panteoni i nëndheshëm- sprovë pas burgut për të tjerët dhe veten*, Uegen, Tiranë, 2020, f.10.

¹¹po aty

¹² Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe-botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020. f.102.

¹³ Visar Zhiti, *Kartela të realizmit të dënuar dhe panteoni i nëndheshëm- sprovë pas burgut për të tjerët dhe veten*, Uegen, Tiranë, 2020, f.403.

¹⁴ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe-botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020. f.103.

“ Burgu dhe format jetësore që i imponon ai kanë ndikim të thellë edhe në procesin e letërsisë që krijohet brenda burgut, që nga motivet dhe idetë, ligjërimi, fjalësi dhe figurat e deri te krijimi i zhanreve të veçanta të artit e letërsisë.”¹⁵

Në historikun e zhvillimit të letërsisë shqipe, letërsia e krijuar nga burgu shquhet për kohën dhe vendin e shkrimit të saj, zhanret letrare të përdorura, motivet dhe temat. Për shkak të kushteve të burgut, shumica e autorëve kanë shkruar poezi, me një fjalë për shkak të imponimit të burgut mbi letërsinë.

“ Periudha krijuese e letërsisë nga burgu është e gjatë dhe jo propocionale në prodhimtari. Mbi bazën e diskutuar të ndërlidhjes me procese politike, mund të përkufizohen dy periudha kohore të letërsisë nga burgu:

-Periudha e parë: nga viti 1945 deri në vitin 1981;

-Periudha e dytë nga viti 1981 e deri në vitin 2000.

Vepra e parë e periudhës së parë është *Libri i burgut* (Romë, 1959) i Arshi Pipës. Ndërsa vepra e parë e periudhës së dytë është *Libri i Lirisë* (Prishtinë, 1991), antologji e poezisë së pesë autorëve, Merxhan Avdyli, Ismail Sylaj, Hydajet Hyseni, Januz Januzaj dhe Bajram Kosumi.”¹⁶ Duke përmendur këto vepra të para të dy periudhave, të cilat në përmbajtjen e tyre kanë poezinë shohim se ajo e dominon këtë letërsi. Në parathënien e librit të tij, Arshi Pipa, për poezinë si zhanër shkruan:

“Vargu asht për natyrë të vetën synthetik, edhe atëherë kur asht përshkruar. Ose, me fjalë ma të shkoquna: zen vend ma pakë dhe ruhet ma mirë. Prandej << Libri i Burgut>> u-shkruejt në varg. Auktori deshi qi << Libri i Burgut>> të mos ishte vetëm një seri kronologjike faktesh të jetës së burgut. Bashkë me faktet atij i rrinte për zemër të jepte edhe jehonën e tyre në shpirtin.”¹⁷

Kurse për veprën e poezive të burgut “Libri i Lirisë”, Agim Vinca shprehet kështu:

¹⁵ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.111.

¹⁶ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.76.

¹⁷ Arshi Pipa, *Libri i Burgut, Botim i dytë*, Rilindja, Tiranë, 1994, f.10.

“Poezia e këtij libri mund të quhet poezi mbi fatin dhe biografinë e një brezi. Ajo ngërthen në vete ëndrrat dhe dëshirat, përpjekjet dhe sakrificat e një gjenerate të tërë për liri e pavarësi: gjakimin e njerëzve të këtij trualli për ta krijuar zogun e zaitë të lirisë, siç shprehet njëri prej tyre. Ky është libri i parë i studentëve tanë poetë, që, pas vitit 1981, nga bankat e fakultetit, u gjendën në burg: libri i pesë nga ata talenti poetik i të cilëve nuk mundi të zhvillohej normalisht: i pesë nga ata që vargjet e tyre më të bukura i shkruan me jetën dhe rininë e vet.”¹⁸

“Poezia e shkurtër lirike, e zë vendin e nderit në këtë letërsi. Kjo për disa arsye. Së pari, kjo lirikë nuk është e krijuar për burgun, por vjen nga burgu, rrjedh nga burgu, del nga burgu dhe bartë mesazhe të lexuesit. Raporti burg – liri (jetë – vdekje), në kuptimin më të gjerë të këtyre fjalëve, është brumi i kësaj poezie dhe ky është një prej fakteve poetike që e bën të një lloji këtë lirikë. Është histori më vete komunikimi i kësaj poezie me lexuesin. Një herë është, pothuajse, një komunikim misterioz, i fshehtë, duke u shpërndarë një poezi fshehurazi nga një dorë te tjetra, e herën tjetër është mos komunikim disavjeçar, për të dalë në dritë me vonesa dhjetë e më tepër vjeçare. Nuk është një komunikim i natyrshëm.”¹⁹

Poezia nuk paraqet vetëm një zhanër të letërsisë por shumë më shumë. Poezia në burg është krijim i cili tregon jetën e të burgosurve, bart me vete një histori, tregon për një nga periudhat më të vështira dhe më krenare për historinë dhe letërsinë shqipe.

1.3 Përjetimi i letërsisë (poezisë) së burgut nga lexuesi

“Letërsia nga burgu shkruhet në situata të pazakonshme dhe pa besimin se ka për të qenë letërsi e lexuar nga lexuesi i zakonshëm.”²⁰

¹⁸ Merxhan Avdyli, Ismail Sylaj, Hydajet Hyseni, Januz Januzaj, Bajram Kosum, *Libri i lirisë*, Embeta, Prishtinë, 2020, f.3.

¹⁹ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.112-113.

²⁰ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore në Shkup. 2020, f.200.

“Jeta është më e pakët se shpresat

E megjithatë unë shkruaj poezi

pa m’i lexuar askush.”²¹

“Ajo është letërsi që ruhet fshehurazi dhe kur bie në duar të policisë, në rastin më të butë, shkatërrohet dhe zhduket, e në disa raste autorët ndëshkohen. Pra, kjo është një letërsi e shkruar dhe e ruajtur me fanatizëm nga vetë autorët. Janë disa raste kur autorët kanë sajuar libër në dorëshkrim, fletore-libër, përmbledhje me poezi të ndarë në kapituj etj, dhe ata libra-fletore kanë qarkulluar brenda burgut, nga dora në dorë, fshehurazi, për lexim.”²²

“Autorët e kësaj letërsie në shqip kanë qenë të burgosur politikë, apo “të burgosur të ndërgjegjes” si është përdorë ky nocion nga disidenca politike- letrare në vendet komuniste. Procesi i vuajtës së këtyre autorëve ka kaluar nëpër dy etapa: së pari duke e përjetuar vetë burgun dhe së dyti, duke e përjetuar atë në letërsi, si proces krijues. Ky procesi i dytë është kujtesë. Të njëjtën kujtesë, mbase me intensitet të njëjtë, mund ta përjetojë lexuesi i ndërgjegjshëm sot dhe në të ardhmen.”²³

“Procesi i kujtesës iniciohet në aktin e krijimit të letërsisë. Kujtesa këtu është personale dhe autoriale. Në rastet më të zakonshme, kjo letërsi bartë përvojat e situatave jetësore nga kushtet e jashtëzakonshme të burgut, prandaj ajo do të shërbejë edhe si një kujtesë për secilin lexues të saj. Kujtesa personale tashmë shndërrohet në kujtesë kolektive. Leximi i sotëm i kësaj letërsie është kujtesë kolektive, e asaj që fillimisht ka qenë kujtesë personale. Individidi është burimi i këtij procesi (edhe atëherë kur individ, pra autori, nuk e ka pasur atë synim) dhe kolektivi është marrësi.”²⁴

²¹ Visar Zhiti, *Kujtesa e ajrit, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve*, Tiranë, 1993, f.83(Epilogu).

²² Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore në Shkup. 2020, f.200.

²³ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore në Shkup. 2020, f.200.

²⁴ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore në Shkup. 2020, f.210-211.

Letërsia, si edhe çdo lloj arti tjetër nxit fuqishëm ndjenja dhe përjetime estetike. Letërsia krijohet për tjetrin (lexuesin), sidomos poezia, si formë e shkurtër, e cila ka një komunikim të veçantë me të.

“Përjetimi artistik është përshtypja që e fitojmë në takimin me veprën artistike.”²⁵ Duke lexuar letërsinë nga burgu, specifiksht poezinë shkaktohen ndjenja emocionale, duke u shoqëruar kështu me mendime të ndryshme mbi situatat me të cilat përballeshin këta autorë si: robërinë, ndëshkimin, vdekjen, çnjerëzimin, frikën, dhunën, dëshirën apo nevojën për të qenë i lirë, mohimin e të drejtës për ta shprehur atë që kanë në mendje apo ndjejnë (lirinë e fjalës). Mbi këto fjalë, mund ti përmendim vargjet e poezisë: “Poezia që do të doja ta shkruaja” të Bajram Kosumit:

“...do të doja të shkruaja mijëra poezi si mijëra

poetë

Por ditët gjithnjë po më shkasin

Duke vrarë mendjen

Cilin sy do të ma nxjerrin nesër

*Cilin shok nesër do të ma vrasin!”*²⁶

Autori, Visar Zhiti në vargje të poezisë së tij “Neveria” e përshkruan detajisht një formë të çnjerëzimit- situatë e vërtetë brenda burgjeve:

“në burgun e këtij shteti hermetik

WC-të janë pa dyer,

të hapura,

radhë-radhë

²⁵ Milivoj Solar, *Teoria e letërsisë*, Rilindja, Prishtinë, 1928, f.68.

²⁶ Bajram Kosumi, *Fjalor i Barbarëve*, Brezi 91, Prishtinë, 2000 (botim i dytë 2010), f.110.

përballë njëra-tjetrës.”²⁷

Mohimin e jetës, kundërrjetën e vërejmë te vargjet e poezisë “Antiprometeu” të autorit Ismail Syla:

“Të thyer njeriun e deshën antiprometetë

Të zhdukur si popujt në Librin e lashtë...”

Figura e Prometeut është e njohur që nga mitet greke. Simbol për ndihmën e njerëzimit për të ecur përpara, për tu zhvilluar. E kundërta e Prometeut apo Antiprometeu. Filozofia e vetë jetës qëndron në të ashtuquajturin njeri. Me të fillon e vazhdon jeta, por kur ai zhduket, mbaron edhe ajo.

“Midis zhdukjes e harrimit njeriu qëndroi përpjetë

Midis zhdukjes e thyerjes gjurmë të thella la.

Antiprometeu i ligur me tmerr një fjalë e thotë:

*“Njeriu prore mbeti njeri, ai bëri, ndjeu e tha.”*²⁸

Raporti jetë- vdekje, e mirë- e keqe: Nuk ka se si të mos e ndjesh aq thellë e ta kuptosh se si kundërshtohet më keq njeriu në piramidën e jetës, por, mbi të gjitha arrin të jetë në majën e saj, duke e mundur kështu të keqen, kundërshtarin e jetës.

Mënyra se si shkruhej në burg, është një përjetim tjetër i veçantë. Autorët e shprehin këtë mënyrë përmes poezisë. Në vargjet e tyre shprehin sakrificat, dhimbjet, vuajtjet, dënimet etj. Njëri nga ata, Avdush Canaj në poezinë e tij thotë:

“ Vjershat i shkruaj tinëz,

edhe nën batanije.

²⁷ Visar Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993, f.58.

²⁸ Ismail Syla, *Tempulli i braktisur*, Rilindja, Prishtinë, 1998, f.11.

Një ditë më zunë

me pelë për dore.

Dhelparakut që më spiunoi

ia hoqën 6 muaj burgim,

në shpinën time i ngarkuan

pa gjyq.”²⁹

E vështirë ishte të shkruash në burg, fshehja e gjithçka tjetër mbi të, duke e përdorur figurën e personifikimit, shohim vargjet:

“ Lapsit tim

ia nxorën zemrën.

Ia dëgjova ofshamën e kaltër

Oh!

S’ lejohet këtu të shkruhen vargje.

Ato nuk m’i gjeti gardiani,

i kapërdiva shpejt

si letrën sekrete ai partizani.”³⁰

Vargjet e kësaj poezie tregojnë se si rrezikohej, ndalohej ose edhe zhdukej e tëra letërsi e shkruar. Lapsi e letra ishin mjetet me të cilat shkruhej, e gardianët bënë çmos ti zhbënin ato kurse të burgosurit mundoheshin t’i ruanin vargjet me çdo kusht edhe pse ridënoheshin.

Autori, Bajram Kosumi, mënyren e rrezikur të shkrimit të poezisë e shpreh në një formë tjetër. Njërin nga poezitë e tij, ai e titullon: *“Ninullë për poezinë”*. Me këtë rast, duke u munduar të

²⁹ Avdush Canaj, *Edhe ëndrrat në pranga(Lirika nga burgu)*, Armagedoni, Prishtinë, 2022, f.49.

³⁰ Avdush Canaj, *Edhe ëndrrat në pranga(Lirika nga burgu)*, Armagedoni, Prishtinë, 2022, f.46.

fsheh vështirësitë, nuk i thotë drejtëpërsëdrejti, duke përdorur fjalën ninullë, zakonisht kjo përdoret për të heshtur zhurmën, pra, trysninë për poezinë e shkruar brenda burgut:

“Në mëngjes vura në gjumë

Një poezi.”

Por në vargjet e tjera jo vetëm fshehje, duke përdorur për simbol Homerin, poetin e lashtë, shpreh ndjenjat lirike, tregon edhe shkrimin (krijimin) e poezisë, e cila vazhdimisht ishte në presionin e forcave të jashtme:

“Fli, i thashë, o Homer,

Se vjen ujku e të ha.”

Përmes figurës së shkallëzimit (gradacionit) renditet dhuna mbi poezinë e deri tek e tëra, zhdukja e saj:

“Për një metaforë

Ta grinë mushkërinë

Synin ta groposë

Zemrën ta merr.”³¹

³¹ Bajram Kosumi, *Fjalor i Barbarëve*, Brezi 91, Prishtinë, 2000 (botim i dytë 2010), f.15.

Kapitulli II

2.1 Liria dhe robëria në poezinë nga burgu

Poezia nga burgu është krijuar nga ide të shumëllojshme por disa nga më të pranishmet janë liria dhe robëria, këto ide mund të emërohen ndryshe, me një fjalë të përbashkët “ më e prekëshmjë” në poezinë nga burgu. Burgu, të vjedh lirinë e të dhuron robërinë, e njeriut i mbetet të vazhdojë tutje brenda, duke zgjedhur vargun si mbështetje për ekzistencë, shpresë për të vazhduar:

“dhe të mendosh

që edhe mbishkrimet e varreve.

kanë lexues...

Atëherë poezia është më shumë se sa shpresat!”³²

³² Visar Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993, f.84(Epilogu).

Si shprehet ideja poetike e lirisë në poezi të burgut, më mirë e kuptojmë nga përkufizimet e Bajram Kosumit në librin e tij:

“Liria qenëson në çdo varg të kësaj lirike, më shumë, në çdo rrokje të saj. Ajo merr të gjitha kuptimet e mundshme poetike, filozofike, njerëzore, natyrore, madje edhe të asaj shtazore. Ajo nuk është vetëm liri kombëtare apo politike, si do të mund të pritej, po liri në kuptimin më të gjerë të fjalës është liri në kuptimin e zhvillimit të historisë së njerëzimit (zbulimi i rrotës apo i sëpatës përjetohet sikur të ishte zbulim i vetë autorit të poezisë!), liri në kuptimin e dashurisë ndaj femrës, është etje për gjelbërim, etje për për sytë e bukur të vashës, është guxim për të krijuar, është shpirt që s’e mban burgun, është ëndërr e bleruar, është Maratonomak, është mëngjes, është mall për tokën, është toka pjellore, është buzëqeshje, është poezia e shkruar...”³³

“Mbas temave dhe motiveve, figurat dhe idetë poetike e veçojnë lirikën nga burgun mjaft mirë nga pjesa tjetër e letërsisë shqipe e shkruar në të njëjtën kohë. Këtu mbizotërojnë figura, simbole e ide poetike ose krejt origjinale (simbolika personale), ose në kuptime të reja dhe të tjera nga ato që i njeh letërsia shqipe.”³⁴

Vetë, gjendja e robërisë të kufizon në shumë gjëra, duke u nisur nga hapësira fizike (objektive) - jo liri në lëvizje e deri te hapësira subjektive - jo liri për tu shprehur sa dhe si duhet. Antiteza e lirisë, robëria (mbyllja) është e shprehur në shumë vargje të poezive me figura, simbole e fjalë të ndryshme. Duke qenë të shtyrë nga kjo gjendje autorët e poezisë së burgut krijojnë disa fjalë-simbole si: qeli, hekur, griliadë, pranga, kafaz, rrënjë, numri katër, si p.sh: katër mure, katër pasqyra, etj.

2.2 Poezia dhe interpretimi

Sipas Aristotelit: “Puna e poetit nuk është të rrëfejë atë që ka ndodhur në të shkuarën por atë që do të ndodhë – pra, duhet të merret me atë që ka gjasë të ndodhë si mundësi dhe nevojë. Poeti

³³ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.165-166.

³⁴ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.100.

rrëfen ato që duhet të ndodhin. Prandaj edhe poezia është më filozofike dhe më serioze. Të vërtetat universale merren me atë që do t'i sillte begati personit dhe të cilën do ta thoshte apo do ta bënte në përputhje me mundësinë dhe nevojën e tij. Ky është synimi i poezisë.”³⁵ Duke parë më afër këtë mendim mund të pohojmë se poezia nuk e jep vetëm realen por edhe të mundshmen, imagjinaren, pra jo çdo herë duhet të jetë në një vijë me realitetin. Poezia është më enigmatike.

“Poezia përfaqëson një krijim me dendësi të madhe kuptimore e të ideve dhe me shprehësi të madhe të fjalëve, të figurave, simboleve, alegorive. Shumë poetë i ndërtojnë kuptimet në poezi duke i rreshtuar fjalët në një rrjedhë interesante dhe të befasishme për lexuesin e mësuar me shprehjen e zakonshme të përditshmërisë ose të shkrimeve të tjera. Një pjesë e mire e fjalëve nuk janë të përdorura me kuptimin e tyre të zakonshëm, domethënë të pare, por në përdorim poetik ndërtojnë sipër tyre kuptimet që janë simbole, alegori ose aluzione të caktuara.”³⁶

Poezia është një krijim më i shkurtër në krahasim me zhanret e tjera letrare dhe për këtë arsye është pak më e vështirë të deshifrohet. Të interpretosh një poezi do të thotë të nxjerrësh copëzat që e përbëjnë brumin e saj. Interpretimin mund ta fillojmë nga titulli i poezisë- duke u nisur nga idetë, të cilat na dërgojnë deri tek tematika, motivet, figurat etj.

“Poezia mund të kuptohet e të përjetohet më së miri përmes zbërthimit të figurës së saj. Figurën vazhdojmë ta kuptojmë në mënyrë tradicionale: si figurë të tekstit [tingujve], si figurë të fjalëve, si figurë të ideve apo të kuptimeve, dhe si figurë sintakse.”³⁷

Poezia nga burgu është e ndërtuar me shumë figura stilistike. Duke zbërthyer këto figura do të shohim më mirë se si janë veshur idetë e poezisë, përkatësisht dy nga ato, liria dhe robëria. Në këtë interpretim hyjnë poezitë e këtyre autorëve: Arshi Pipa, Kasëm Trebeshina, Ismail Syla, Bajram Kosumi, Merxhan Avdyli, Visar Zhiti, Avdush Canaj, Hydajet Hyseni, Rasim Selmanaj, Besim Zymeri.

³⁵ Aristoteli, *Poetika*, Albas, Tiranë, 2023, f.34.

³⁶ Zejnullah Rrahmani, *Teoria e letërsisë, (botim i dytë i plotësuar)*, Faik Konica, Prishtinë, 2008, f.179.

³⁷ <https://bajramkosumi.com/wp-content/uploads/2023/11/Poezia-nga-burgu.pdf>

Nga këta autorë kam përzgjedhur disa nga poezitë të cilat në brendësinë e tyre kanë lirinë dhe robërinë si mbështjellës. Duke interpretuar apo zbërthyer vargjet e poezive nga fjalët me të cilat ndërtohen, me figurat si: metafora, simboli, personifikimi, anafora, antiteza... etj.

2.2.1 Arshi Pipa

Nismëtari në letërsinë dhe krijimimtarinë nga burgu është Arshi Pipa. Poezia e tij shfaq formën më të tmerrshme të të qenit i robëruar. Këtë formë e paraqet në poemën e tij “Kanali” e përbërë nga njëzet e pesë sonete. “ Soneti është i përbërë nga dy katrena dhe dy tercina ose një strofë prej tetë vargjesh e një prej gjashtë vargjesh.”³⁸ Pipa, këtë poemë e emëron “Kanali” sepse këto vargje ai i shkroi gjatë qëndrimit nëpër kampet e burgjeve më saktësisht gjatë punëve të rënda të bëra në kanale. Studiuesi dhe autori i letërsisë nga burgu, Visar Zhiti për librin e Arshi Pipës shprehet: “Sonetet e Kanalit të asaj kënete të tmerrshme burgu do të ishin sipas meje, “Ferri” i poezisë shqipe”.³⁹

Nga vargjet e poezisë së Arshi Pipës kemi marrë disa për interpretim:

Soneti III:

“A mund të quhen njerëz? Qe, shikoj.

Fëtyra dheu ku syt e shojtun ngrohen

kur shofin bukën;faqe qi gropohen

e nofulla qi dalin si patkoj.

Në fillim të këtyre vargjeve autori e përdor **pyetjen retorike**, duke vënë në pikëpyetje krijesën “njeri” kjo si rezultat i kushteve të vështira të burgut, të cilat e kanë tjetërsuar. Mungesa e ushqimit të burgosurëve i ka ndryshuar edhe gjendjen e fytyrave, këtë e shpreh përmes figurës së

³⁸ Milivoj Solar, *Teoria e letërsisë*, Rilindja, Prishtinë, 1928, f.138.

³⁹ Visar Zhiti, *Kartela të realizmit të dënuar dhe panteoni i nëndheshëm- sprovë pas burgut për të tjerët dhe veten*, Uegen, Tiranë, 2020, f.98.

metaforës: fëtyra dheu, syt e shojtun ngrohen, faqe qi gropohen; figurës së **krahasimit** – si patkoj.

Për të qëndruar e vazhduar jetën, njeriut i duhet edhe forca e trupit, por për të burgosurit ajo forcë ishte e dobët nga rrethanat e burgut. Në fillim të katrenës së dytë autori e përdor figurën e **metonomisë**- që tregon lodhjen(shterrjen) e fuqisë trupore:

Kambët s i mbajnë e krahët u rrëzohen

***Si dordoleca** lkunden qi vendoi*

*mbi hunj kopshtari. **Njerëz kta ksisoj?***

Shauretën⁴⁰ janë qi nga vorrezat çohen. ” ⁴¹

Në vargjet e tjera, i burgosuri e ndjen veten të pafuqishëm, qesharak për t’u tallur nga të tjerët- **si dordoleca** - këtë e thotë përmes figurës së **metaforës** dhe **krahasimit**. Sfidat e vështira që i kalon, përballimin e urisë e të gjitha i vë prapë në pikëpyetje- duke e përdorur **pyetjen retorike**: Njerëz kta ksisoj? Vargu i fundit i katrenës përmbyllet me një **metaforë të fortë**- Shauretën janë qi nga vorret çohen- Na lë të kuptojmë se nga vështirësiitë e burgut, njeriu është shndërruar në një hije (fantazmë) por prapë është në jetë!

Fjalët e përdorura në poezinë e Arshi Pipës janë shprehje nga të folurat e popullit, kryesisht të qytetit të Shkodrës.

Vargjet e dyta të sonetit, tercinat fillojnë me një **antitezë** dhe **metaforë** :

*“**Njerëz kanë qenë. Sot janë veç zhele mishi,***

*automa **kockash**, një **bërsi**, një **pleh**,*

ku veç prej emnave dallon e njeh

Njeriu, si krijesë në tokë është i prirur për të qenë i vlefshëm por burgu, robëria, punët e rënda, detyrimet e shumta e kanë kthyer atë në një cope të pavlerë. Të burgosurit janë bërë të gjithë të

⁴⁰ Hije, fantazëm

⁴¹ Arshi Pipa, *Libri i Burgut, Botim i dytë*, Rilindja, Tiranë, 1994, f.64.

tillë, të shtypur, të mjerë. Shtresat e ndryshme të popullsisë: të pasurit, klasa politike, fshatarët, spijunët, tregtarët, atdhetarët, të gjithë ishin njëjtësuar:

bujkun nga beu, tregtarin nga dervishi,

kusarin, simahorin, lakanderin

prej atdhetarit qi luftoi për nderin.”⁴²

Soneti IV:

“Por eja tash e shifî ndaj kanalit:

Njimijetreqind vetë, një mizëri.

Lopata e bela tunden me furi

e qerrkat mbarin plisat e moçalit.

Të burgosurit ishin të detyruar të kryenin punët e rënda në hapjen e kanalit dhe kjo vlente për të gjithë, me mjetet që i bartnin me vete. Përmes figurës së **metaforës**: Lopata e bela tunden me furi- autori tregon punën e pandalshme që e bënin. Po ashtu, qerrkat ishin mjete më të rënda për tu bartur dhe ato i bartnin më të moshuarit apo më të dobët; figura e **metonomisë** – plisat e moçalit.

Tri metra e gjysëm kub për çdo njeri.

Qofsh babagjysh qi ke djalin e djalit,

a qofsh i smundë sa dalun prej spitalit,

bani ja vdis: ankimi s ban dobi.”

Gërmimi i tokës, puna që duhet bënë ishte e caktuar për secilin njësoj, s’dallonte as nga mosha e as sëmundja. Robëria, tmerri i punës së rëndë mund të çonte edhe deri te vdekja por fatkeqësisht

⁴² Arshi Pipa, *Libri i Burgut, Botim i dytë*, Rilindja, Tiranë, 1994, f.65.

edhe ajo, nuk tregonte mëshirë për të burgosurit. Figurë stilistike e përdorur në këto vargje është **enumeracioni** – Qofsh babagjysh qi ke djalit e djalit....

Mjetet e punës, të rënda apo jo, pa marrë parasysh distancën se ku duhet shkonin duhet t'i bartnin me vete, edhe pse peshat u shkaktonin dëmtime trupore:

*“Shef të **gjymtuem** e pleq ngarkue mbi shpina*

Dhogat e randa e qerrkat mbi kaptina,

qi hinë e ngrihen e zvarnisen krrut.

S'mjaftonte vetëm tmerri i punës së rëndë, ndaj të burgosurve ushtrohej edhe dhunë me mjete të forta, që disave u shkaktonte vdekje- vargu i fundit i tercines përmbillet me figurën e **metonomisë**:

U mshon polici me dajak sa mundet.

Por ndodhë sa herë qi njeni sish nuk tundet.

***Me vig e çojnë e vigu mbrrin tabut.**”⁴³*

2.2.2 Kasëm Trebeshina

Ndër poezitë më të hershme të krijuara në burg, janë ato nga Kasëm Trebeshina. Mënyra se si shkruan Trebeshina paraqet një modernizëm të veçantë të poezisë e letërsisë shqipe. Studiuesi dhe autori i letërsisë nga burgu, Bajram Kosumi në librin e tij “Letërsia nga burgu” për Kasëm Trebeshinën shkruan:

“Ai nuk e ka nënshtruar letërsinë e tij ndaj dogmës letrare, por ka vazhduar të shkruaj sipas shijeve të tij estetike moderne. Ai është vetmitari që shkruan pa pasur lexuesin, por vetëm i

⁴³ Arshi Pipa, *Libri i Burgut, Botim i dytë*, Rilindja, Tiranë, 1994, f.65.

bindur nga idetë e tij letrare dhe estetike. Ai shkruan ndryshe nga të gjithë të tjerët, por sipas shijes së vet estetike dhe pa lexuesin, e kjo e bën atë poet të madh modern.”⁴⁴

Burgu, sado që të ketë peshë, për të burgosurin gjithmonë do të ekzistojë një mënyrë për t’a lehtësuar. Trebeshina këtë e dëshmon në vargjet e poezisë së tij. Një nga këto mënyra është lutja, për tu zhveshur nga robëria, për t’u ndjerë një krijesë, ashtu siç erdhi në jetë, krejtësisht i lirë:

Të më jepnin Zotat mua

si Orfeut një fuqi,

do t’i ringjallja gjith’ sa dua

të jetonin në liri!...⁴⁵

Orfeu nga mitet greke është i njohur për lutjen e pranuar, që iu bëri zotërave që t’ia kthenin gruan e tij, Euridikën në jetën tokësore nga vdekja. Kështu, autori duke qenë i robëruar kërkon një fuqi të tillë, të ndryshoj fatin e tij, të jetë i lirë dhe të ketë mundësinë edhe të vdekurit t’i rikthejë në jetë. Figurë stilistike e përdorur është **metafora**- Të më jepnin Zotat mua- **krahasimi**: si Orfeut një fuqi.

Duket Zotat lindin, vdesin...

Dhe s’arrijn’ këtu te ne!

Ndaj të vdekurit të presin

Sa të vemi ne atje!⁴⁶

Zotat kanë forca të larta, hyjnore për të ndryshuar gjërat, por sado e madhe të jetë kjo lutje ndaj zotërave, është e kotë sepse në burg si duket nuk i dëgjojnë. Në fillim të këtyre vargjeve autori e

⁴⁴ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.251.

⁴⁵ Kasëm Trebeshina, *Polimnia dhe Melpomene 1*, Faik Konica, Prishtinë, 2006, f.23.

⁴⁶ Kasëm Trebeshina, *Polimnia dhe Melpomene 1*, Faik Konica, Prishtinë, 2006, f.23.

shpreh këtë me anë të **paradoksit**: Zotat lindin, vdesin. Meqënëse nuk mund të jetë i lirë e të bëj ndonjë gjë tjetër, e di se një ditë do të vdes, do të bashkohet me të vdekurit.

“Fluturimi i zogut”

“Bëj të dukem i duruar,

se i rritur jam tashti!

po për nënën jam malluar,

e kam mendjen në shtëpi!”

Nga titulli i poezisë, zogut, një shpend i cili **simbolizon** pafajësinë, lirinë, një të vogël, diçka krejtësisht fillestare. Në këto vargje, me zogun autori **personifikon** veten, i cili ka kaluar, përjetuar shumë sfida në jetë, dhe sado të jetë në moshë përsëri malli për nënën e kthen në një fëmijë, në çerdhen e ngrohtë, ku nisi rrugëtimin e tij.

Kur një zog hap krahët n’ erë

dhe kalon përtej mbi pyll,

në vend tjetër do të flerë

duke par’ gjithnjë një yll!...

Sado rrugëtime të ketë bërë, larg të ketë shkuar, gjithmonë do të ketë pamjen e paharruar të vendit të parë, vendlindjes, e cila është kurdoherë e ndritshme!

*Ndaj un’ sot i **përmalluar***

dua që të jem fëmi!...

Ngase te nëna i nxituar...

*Zgjohem prap ku jam tashti!*⁴⁷

Dëshira për t'u ndjerë fëmijë, për të vrapuar te nëna i krijon atij lirinë. Këto ndjenja i shpreh me anë të **epiteve**: i përmallur, i nxituar. Por, fatëkeqësisht prapë vetëm ëndërron, ditën tjetër është i mbyllur përsëri.

2.2.3 Ismail Syla

Poezinë e Ismail Sylës e shquan përdorimi i shprehjeve të mbushura me shumë figura, mbase mund ti quajmë edhe hermetike. Poezia e tij nga kritikët e letërsisë, emërohet si poezi intelektualiste. Disa poezi, të cilat i kemi përzgjedhur kanë tematikën e lirisë dhe robërisë, si p.sh:

“Liria”

Bijë e lashtë e stërgjyshërve

Me sy të tmerruar nga nata

Ku mbet ai fëmija i druajtur

Që s'preku flokët tua të gjata.

(Ylberet e rrëmbyen?)⁴⁸

Autori që në vargun e parë e **personifikon** lirinë me emrin “ **bijë e lashtë e stërgjyshërve** ”, duke vënë në pah se sa e shenjtë dhe për sa kohë është në pritje ajo. Pastaj sytë e tmerruar janë të shqetësuar për lirinë, të frikësuar dhe të rrezikuar nga forcat e errëta. Prekja e flokëve të gjata paraqet një dëshirë për ta mbajtur lirinë si të shenjtë – **metaforë. Pyetja retorike** – shfaq

⁴⁷ Kasëm Trebeshina, *Polimnia dhe Melpomena 1*, Faik Konica, Prishtinë, 2006, f.18.

⁴⁸ Ismail Syla, *Tempulli i braktisur*, Rilindja, Prishtinë, 1998, f.22.

rrezikun se shpresat janë të pakta për liri, të rrëmbyera nga ata që duan ta mbajnë njeriun në errësirë.

Strofa e parë nis që nga fëmija, vazhdon me djaloshin e ri, burrin (babain me fëmijë), duke e përfunduar me plakun, të gjithë, pa dallime, ëndërrojnë, duan, sakrifikohen, për të përbashkëtën, lirinë! Po ashtu, në anën tjetër janë personifikim i saj:

Ku treti ai djaloshi me sy të ndritur

Që ëndërronte dashurinë e parë

***(Zanat e gurëzuan?)*⁴⁹**

Këto vargje simbolizojnë rininë, dëshirat për ti arritur ëndrrat e bukura, pafajësinë por këto kthehen në të kundërta- figura e **metaforës** – e gurëzuan.

Po ai plaku rrëzë amshimit

Me një këmbë që po shkel në varr

Pse s'mbyll sytë tutje të niset

Një përkëdhelje pret ta marrë.

***(Engjëjt pamjen ia ngatërrojnë?)*⁵⁰**

Ndonëse në prag të vdekjes, dëshira për liri është e patjetërsueshme.

Bijë e lashtë e stërgjyshërve

E virgjër po erdhe me sytë plot dritë

Në fije bari të tharë mbi varr

Si kumt dërgoji ... përkëdhelitë.

⁴⁹ Ismail Syla, *Tempulli i braktisur*, Rilindja, Prishtinë, 1998, f.22.

⁵⁰ Ismail Syla, *Tempulli i braktisur*, Rilindja, Prishtinë, 1998, f.22.

(Sinjalit i besohet?)⁵¹

Në mënyrën e të shkruarit në vargje kjo poezi është e veçantë, secilë strofë përmbillet me një **pyetje retorike** në fund. Figurat stilistike me të cilat ndërtohet kjo poezi janë: **anafora** – Kemi përsëritjen e fjalës “ **bijë e lashtë e stërgjyshërve** ” – Liria, si shprehje po ashtu është veshur me shumë mbiemra cilësor- **epitete**: e lashtë, me sy të ndritur, e virgjër, i druajtur etj. Po ashtu, **metafora**- Me një këmbë që po shkel në varr. **Pyetjet retorike**: Ylberet e rrëmbyen? Zanat e gurëzuan? Sinjalit i besohet?

“Kabineti im”

*Në kabinetin tim ka **katër mure***

*Në **katër** muret*

***Katër** pasqyra*

Ku shihem çdo ditë.

***Pasqyra** e parë - buzëqeshja e zymtë.*

***Pasqyra** e dytë - hidhërimi.*

***Pasqyra** e tretë - gjurmë pagjumësie.*

***Pasqyra** e katërt - shpresa.*

Diell i varur prapa resh.⁵²

Kabineti, në përgjithësi është një dhomë pune apo studimi por përmes figurës së **metaforës** - katër muret është vendi i mbyllur ku autori qëndron. Dhe këto katër mure i quan pasqyra sepse çdo ditë ballafaqohet me gjëra të njëjta, pasqyrojnë buzëqeshjen e vrenjtur, hidhërimin, pagjumësinë por përtej këtyre prapë ekziston shpresa, për ta ngrohur shpirtin me liri- këto

⁵¹ Ismail Sylaj, *Tempulli i braktisur*, Rilindja, Prishtinë, 1998, f.22-23.

⁵² Ismail Sylaj, *Tempulli i braktisur*, Rilindja, Prishtinë, 1998, f.29.

pasqyra edhe **personifikojnë** ndjenjat e autorit. Figura dominante është **anafora**- duke përdorur shumë herë fjalët katër dhe pasqyra- të cilat në fakt janë burgu.

Të qëndruarit në burg të shkakton ndjenja e mendime të çuditshme. Ismail Syla përdor për **simbol**, Robinson Kruzon dhe vetminë në burg e paraqet përmes tij. Në vargjet e poezisë shkruan:

Anësujë... Braktisje.

*Si të mos ndjehem **Robinson***

*Mes muresh armiqësore.*⁵³

Në burg, autori e ndjen veten të humbur, të harruar, të braktisur nga të gjithë. Këto vargje ndërtohen prej disa figurave stilistike: **krahasimin**- duke e krahasuar veten me personazhin e njohur – Si të mos ndjehem Robinson; **metaforën** – mes muresh armiqësore- Muret nuk janë thjeshtë vetëm një objekt ku është i izoluar, por një vend ku ndjehet i huaj.

Frymëmarrja e gjallë e vetmisë

Mbështjellë me ajrin e ndenjtur

*Lëkurët e rinisë i palon stinëve.*⁵⁴

Në këto vargje, përshkruhet vetmia si diçka që frymon e gjallë, ani pse vetmia nënkupton heshtjen, pazëshmërinë- këtu përdoret figura e **personifikimit**. Qëndrimi në burg të ngushton jetën, rëndon ajrin- kjo paraqitet me anë të **metaforës**- **Mbështjellë në ajrin e ndenjtur**. Po ashtu, **metaforën** e kemi edhe në përmbylljen e vargut- Lëkurët e rinisë i palon stinëve- autori kujton rininë, përjetimet të cilat i ka të fshehura në mendje e zemër por koha është e pandalshme, vitet ikin e nuk mund ti kthen.

Robëria, shtypja e kontrolli në burg, të gjitha këto përjetohen si një dëshpërim, izolim. Poeti gjendet përballë një botë pa mëshirë.

⁵³ Ismail Syla, *Tempulli i braktisur*, Rilindja, Prishtinë, 1998, f.30.

⁵⁴ po aty

Pa pasqyrë. Në sytë e egër

Të rojës shikoj.

Më kot të zbuten... Helm.⁵⁵

Vargjet janë të ndërtuara nga disa **metafora**: Pasqyra, zakonisht jep një reflektim rrezatues tek njerëzit por në këtë rast ajo nuk është fare, nuk ka ndjeshmëri njerëzore. Sytë e egër të rojës janë të pamëshirshëm, çnjerëzor ndaj të burgosurve – duke dashur t’i zbusin me sy njeriu, por e kotë sepse helmi nuk ndryshohet- ndjenjat e ftofta. Po ashtu, në këto vargje kemi një **ironi** – poeti kërkon diçka lehtësuese por merr më të rëndën- helmin.

2.2.4 Bajram Kosumi

Bajram Kosumi është një zë i dalluar për poezitë e krijuara në burg. Figurat, simbolet fjalët me të cilat ai i shpreh ato përbëjnë një mëvetësi në këtë letërsi.

“Burgosja nuk është një akt i thjeshtë, mekanik, aventuresk, por ajo është rezultat i qëndrimit aktiv në jetë të atij që kundërshton të keqen me bindje të thellë. Është kundërshtimi dhe mohimi i robërisë nga bindja filozofike mbi domosdoshmërinë e të jetuarit i lirë.”⁵⁶ Këtë qëndrim aktiv në jetë, Kosumi e shpreh nëpërmjet poezive të tij:

“Baladë e vogël”

Nuk i qaj ditët që prapa grilave më shkuan,

Veç këtyre mureve,

Oh këtyre mureve

⁵⁵ Ismail Sylaj, *Tempulli i braktisur*, Rilindja, Prishtinë, 1998, f.30.

⁵⁶ Bajram Kosumi, *Fjalor i barbarëve, Brezi 91*, Prishtinë, 2000, (botim i dytë 2010), f.185.

Shpirtin do t'ua nxirrja

Për sa e sa poezi

Ide

Ëndrra

Sa e sa dashuri që m'i shuan! ⁵⁷

Zakonisht, baladat tregojnë fatkeqësi, por autori i vë titullit, epitetin “e vogël”. Ani pse i robëruar prapë nuk e vajton kohën e shkuar. Të jesh me vite i burgosur, jo vetëm që burgos trupin por edhe çdo dëshirë, ëndërr, dashuri të jetës... Poezia është e ndërtuar prej disa figurave stilistike si: **anafora**- ku përdor dy herë fjalët “*këtyre mureve*”, po edhe “*sa e sa*” këto fjalë theksojnë gjendjen shpirtërore, mbylljen, robërinë dhe humbjet e panumërta që shkakton ajo. Një tjetër figurë është edhe **personifikimi** - “*Oh këtyre mureve, shpirtin do t'ua nxirrja*” – meqë rast këto fjalë tregojnë ndërrim gjendjesh. Muret, ndonëse pa jetë shuajnë ëndrrat e njeriut që frymon. Po ashtu, pasthirrma “*Oh*” shpreh një çast nga ana e brendshme, një ndjenjë të fortë!

Robëria, si ide, nocion është në shumë poezi të Kosumit, njëra nga këto:

“Çast robërie”

“I përgatitëm plaçkat, duart shtrënguan,

Ata na i shtrënguan në zinxhirë

Do ta ketë kthyer kokën mos më shihte edhe një herë

*Do ta kenë përplasur në ndonjë **birucë***

*Të ndonjë **burgu të tretur***

*Në **po këso muresh***

⁵⁷ Bajram Kosumi, *Fjalor i barbarëve, Brezi 91*, Prishtinë, 2000, (botim i dytë 2010), f.90.

*Në po këso vuajtjesh ...*⁵⁸

Miqësia në burg është një ndjenjë që dhuron ngrohtësi sepse robëria bëhet më e durueshme. Kosumi këtë miqësi e përshkruan në këto vargje. Dy miq të ngushtë shtrëngojnë duart duke u ndarë nga njëri-tjetri në rrethana të detyrueshme, me mërzi për njëri-tjetrin, me frikë se ndoshta nuk do të takohen më. Figurat e përdorura janë **metafora** – Do ta kenë përplasur në ndonjë birucë ... Vargu përmbyllet me figurën e **anaforës**- në po këso...

“Dhe

Në pagjumësinë e vonshme

*Do të ketë menduar vargjet e reja për lirinë.”*⁵⁹

Pagjumësia si proces për të burgosurin ishte e përditshme jo vetëm në aspektin fizik por edhe atë mendor- gjendje ankthi, mendime të thella dhe trazim shpirtëror, megjithatë shpresa nuk i shuhej asnjëherë për lirinë, këtë lloj rezistence e gjente përmes poezisë.

“Poezia e Kosumit, në vazhdimësi shpërfaq paralelizmin antitetik robëria-liria, i cili si i tillë përshkohet nga një paralelizëm tjetër, por që është pajtues: individ-kolektivi, e që së bashku përvijojnë të gjitha aspektet dhe format e identitetit. Studiuesi i letërsisë Sabri Hamiti, duke folur për poezinë e Kosumit ka hetuar pikërisht segmentin e identitetit. Ai duke e cilësuar poezinë e Kosumit si të kryer, të kristaltë, intelektuale dhe moderne, thotë se ai përmes ideve poetike “artikulon identitetin e vet njerëzor dhe veprues” se e “mbron të drejtën e mendimit dhe të veprimit personal nëpërmjet gjetjes së këtij identiteti në historinë kolektive të kombit”.⁶⁰ Shembull:

“Ode për librat e bibliotekës sime”

Në fillim të vargjeve të para autori shpreh diçka të kundërt me vetveten. Kjo shprehet përmes figurës së **paradoksit**.

⁵⁸ Bajram Kosumi, *Fjalor i barbarëve, Brezi 91*, Prishtinë, 2000,(botim i dytë 2010), f.89.

⁵⁹ Po aty

⁶⁰ <https://bajramkosumi.com/index.php/2023/12/12/poezia-e-bajram-kosumit/>

“Kur më arrestuan

Librave të bibliotekës sime

Në gjoks automatikun ua vunë,

Si futën me dashakeqësi në thes

Si paratë e vjedhura në bankë.”⁶¹

“ Ode- oda është një lloj i poezisë ku tematika e saj, kryesisht, ka të bëjë me ndonjë person ose diçka ndaj të cilit ndihet lidhje, dashuri, respekt i caktuar ose ndonjë lloj afiniteti.” ⁶² Në këtë rast, kjo lidhje është me librat. Në anën tjetër këto vargje mund të interpretohen jo vetëm në arrestimin fizik por edhe atë mendor dhunën, shtypjen e mendimit të lirë. Me një fjalë njeriu i ditur, intelektual dënohej. Në fund të vargjeve përdoret figura e **metaforës** – Si futën me dashakeqësi në thes. Si paratë e vjedhura në bankë- Librat, leximi, dija janë trajtuar si krime, si të padrejta.

“ Atje poshtë, në ferr

E ndjeja veten më të qetë para vdekjes.

Kur e dija që aty afër në një qeli

Qëndronin burrërisht Brehti, Koperniku, Marksi, Hikmeti

Odiseja që e kisha lexuar gjashtë herë

Krejt kompleti i Kadaresë

Khajami, Hamleti...

Dhe kushedi

⁶¹ Bajram Kosumi, *Fjalor i barbarëve, Brezi 91*, Prishtinë, 2000,(botim i dytë 2010), f.83.

⁶² Milivoj Solar, *Teoria e letërsisë*, Rilindja, Prishtinë, 1928, f.180.

*Sa e sa shekuj të tjerë!*⁶³

Vargjet fillojnë me një **metaforë** - Ferrin e përdor për të tregur gjendjen e mjerueshme, por edhe pse ishte në qelinë më të errët prapë nuk shqetësohej. Duke i ditur këto libra me personalitete të rëndësishme, edhe robërinë e përballonte me shumë krenari, duke qenë vetë i burgosur dhe të gjitha librat që i kishte lexuar- figura e **krahasimit**, përsëri **metafora** – qëndronin burrërisht Brehti... Vargjet e fundit shprehin një ndjenjë të pashkëputshme me letërsinë.

2.2.5 Avdush Canaj

Poezia e Avdush Canajt përbëhet nga fjalë të shkurta, të cilat përçojnë mesazhe shumë domethënëse. Ai e përballon robërinë dhe është i pandalshëm për lirinë. Në lirikën e tij nga burgu ndërton artisikisht shprehjet me ide, motive, simbole të ndryshme.

Liria fizike në burg është e kushtëzuar por ajo mendore jo, pikërisht mbi këtë lloj lirie Canaj arrin të krijojë botën e tij letrare. Në parathënien e librit “Edhe ëndrrat në pranga” Adem Gashi shprehet:

“E pra, liria absolute i mbeti mendjes, asaj të pakontrollueshmes e të pandalshmes. Kjo liri mendjeje i dha dorë autorit që edhe me tagrin e sakrificës, brenda burgut, të hedhë nëpër fije të letrës së cigareve botën fiktive, pothuajse si motërzim autentik i botës reale.”⁶⁴

“Ëndërrat me pranga”

Edhe ëndrrat

vijnë këtu të lidhura

⁶³ Bajram Kosumi, *Fjalor i barbarëve, Brezi 91*, Prishtinë, 2000,(botim i dytë 2010), f.83.

⁶⁴ Avdush Canaj, *Edhe ëndrrat në pranga (Lirika nga burgu)*, Armagedoni, Prishtinë, 2022, f.5.

*me pranga.*⁶⁵

Në këto vargje kemi një **antitezë** të fuqishme - ëndrra me pranga. Fatkeqësisht kur je në një vend të mbyllur dhe nuk mund të ndryshosh asgjë, ëndërrat janë shpresë por edhe ato mbeten të kufizuara, të penguara. Me anë të fjalës “pranga” përdor figurën e **simbolit** që paraqet mosrealizmin e tyre.

“Hekura e hekura”

Kot vunë hekura

e hekura

në të katër anët.

Dielli megjithatë përbirohet

kur s’është roja

dhe na i ngroh

duart e akullta.⁶⁶

Me fjalët “**hekura e hekura**” autori shpreh drejtëpërdrejtë mbylljen, kufizimin në të gjitha anët. Por në këtë rast edhe thekson ndjesinë e të qenurit i robëruar dhe kjo figurë është **epifora**(përsëritje). Ndjesia që të ofron robëria si formë duhet të jetë tepër e fortë për të të rënduar shpirtin dhe shpresat por për autorin është e tëra e kotë, sepse nuk arrin ta burgos shpirtin, shpresën, sado që rojat bëjnë përpjekje dhe forca të shuajnë dritën e lirisë, poeti prapë e gjen atë. Në strofën e dytë kemi një **personifikim**- Dielli megjithatë përbirohet. Poezia mbaron me një **antitezë**- na i ngroh duart e akullta.

“Burgu është një çast i gjatë, i gjatë e i padurueshëm. Nevojitet nganjëherë ikja prej tij, e kur s’mund të ikësh i tëri, atëherë së paku zemra duhet të ikë e të freskohet, të marrë pak forcë për të

⁶⁵ Avdush Canaj, *Edhe ëndrrat në pranga (Lirika nga burgu)*, Armagedoni, Prishtinë, 2022, f.22.

⁶⁶ Avdush Canaj, *Edhe ëndrrat në pranga (Lirika nga burgu)*, Armagedoni, Prishtinë, 2022, f-23.

vazhduar betejën e rëndë. Shpirti i njeriut ka nevojë vazhdimisht për liri, për dashuri, për jetë të natyrshme.”⁶⁷ Një shembull është poezia: “*Flas me lirinë*”

“ Më ranë në qafë:

Me dikë flet në qeli.

U thashë me zë të qetë:

E vërtetë

se vërtet

muret e dinë

*se flas me lirinë”*⁶⁸

Liria fizike mungonte por ajo e mendjes e shpirtit jo. E në këtë rast muret ishin, të vetmet që ia dëgjonin dhe kuptonin fjalët e shpirtit, këtu përdor figura e **personifikimit**. Ndonëse trajtohej me egërsi, ai prapë kishte fuqinë e brendshme për tu shprehur i qetë, sepse kjo pjesë, mendimi për lirinë, ishte një ndjenjë që dhuronte një qetësim shpirtëror, një pushim, guxim më tepër për të vazhduar tutje, prapë me burgun:

Çartet qeni i zi:

Mbylleni në errësirë,

në vetmi,

*shtrëngojani prangat mirë!*⁶⁹

Përmendja e fjalës liri, tensiononte edhe më tepër rojet e burgut dhe për këtë edhe ndëshkoheshin dhe futeshin edhe në vendet më të errëta të burgut me një kontroll edhe më të rreptë. Vargu fillon me figurën e **metaforës** – Çartet qeni i zi.

⁶⁷ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.262-263.

⁶⁸ Avdush Canaj, *Edhe ëndrrat në pranga (Lirika nga burgu)*, Armagedoni, Prishtinë, 2022, f-60.

⁶⁹ Avdush Canaj, *Edhe ëndrrat në pranga (Lirika nga burgu)*, Armagedoni, Prishtinë, 2022, f-60.

2.2.6 Visar Zhiti

Sado, Visar Zhiti ka bërë hapat e parë në poezi para se të burgosej, ai është krijuar si poet në burg, dhe kjo është vulë mbi gjithë letërsinë e tij.⁷⁰ Poezia e tij përbën një shumësi temash që prekin shpirtin e lexuesit, një dhembje për ferrin e kaluar në burg. Por, jo vetëm dhembje ajo paraqet shpresë, ëndërr për lirinë dhe pikërisht kjo poezi i bëhet një lloj rezistence, ku përmes vargjeve e paraqet jetën si proces.

Jeta në grila, ballafaqimi me robërinë, përfytyrimi i ambientit të jashtëm, ëndrrat, dëshira për të parë lindjen e perëndimin e diellit; të gjitha zënë vend në vargjet e Visar Zhitit:

I burgosuri

gjithmonë ndodhet pas një dere të mbyllur.

Jashtë duhet të jetë mesditë tërë diell.

Shoh derën e drunjtë. Shkëlqen e tëra

si kopertinë vegimesh e një libri

*të pabotuar kurrë.*⁷¹

Për të burgosurin, nuk mjaftonte vetëm burgu por kishte edhe pengesa dhe kufizime të ndryshme, nuk mund të përjetonte as edhe ndjesinë e lindjes së diellit, ngrohtësinë e ditës etj. Këto vargje autori i ndërton duke përdorur figurën e **antitezës dhe kontrastit**. Duke i theksuar skajshmërisht kundërshtitë që ia mohojnë lirinë; ekziston dera por, është e mbyllur. Një libër i pabotuar kurrë-shumë ëndrra, dëshira, qëllime nuk janë realizur ende.

“Rrënja”

Jam rrënjë

⁷⁰ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.87.

⁷¹ Visar Zhiti, *Dyert e gjalla*, Eurolindja, Tiranë, 1995, f.27.

e dalë në ajër.

Ju shëmb toka

dhe ndihmë s'kërkon. ⁷²

Rrënja, parësorja për t'u mbajtur dhe zhvillur një gjë. Këtë fjalë, Visar Zhiti e merr për **simbol** dhe paraqet veten, trupin e tij, i cili është larguar nga vendi ku duhet të jetë, nga burimi i jetës. Nga të qenit i lirë kalon në robëri dhe kjo gjendje e kthen në një të përmbysur, nuk ka mundësi për tu ndihmuar- **figura e antitezës**.

E verbër.

e errët

pret shiun dhe dritën,

tërmetin pret... ⁷³

Këto vargje poetike vënë në pah atë errësirën, pritjen, ndjeshmërinë apo edhe e tërë shkatërrimin nga kjo shkëputje. Siç shprehet edhe Bajram Kosumi: “*Trimëria vjen nga rrënja, sado pipat dhe filizat çajne të parat ajrin.*”⁷⁴ Pra, forcën për tu zhvilluar e ke nga thelbi, të nevojitet trupi i lirë, i fortë për ti bërë rrënjët në shumë degë. Këto vargje përmbyllen me figurën e **shkallëzimit(gradacionit) zbritës**.

“Ardhja e pegasit në qelinë time”

Nga mitologjia greke fjala pegas ka kuptimin e një kali fluturues. Zhiti arrin të përdorë artistikisht bukur këtë simbol. Kali, **një simbol** i udhëtimit, një gjallesë e lirë për të shkuar kudo. Lirinë e kishte të penguar, ëndrrat jo! E si ta përjeton lirinë? Përmes kësaj krijese, të cilën e ëndërron dhe këtë ndjenjë e paraqet në vargjet:

⁷² Visar Zhiti, *Dyert e gjalla*, Euroindja, Tiranë, 1995, f.16.

⁷³ Visar Zhiti, *Dyert e gjalla*, Euroindja, Tiranë, 1995, f.16.

⁷⁴ Bajram Kosumi, *Enciklopedia imagjinare*, Artini, Prishtinë, Toena, Tiranë.2023, f.62.

Afër frengjisë,

nëpër barin e pakët – patkonj.

Kullostë një kalë

si dikur

si në ëndërr.

Trupi i tij i bukur -

muzg i larë me shi dhe hënë.

Ç' e mirë të solli kështu?

Mos je ti Pegasi?!⁷⁵

Ndonëse nga dritarja më e ngushtë, në një vend të errët ku është i mbyllur ai arrin të përjetojë lirinë, të marrë një frymë nga ajo ëndërr, lirinë që nuk ia ofron njeriu, ia ofron një kalë dhe kjo ndjenjë e bën pafundësisht të lumtur. Këtë e shpreh përmes **pyetjeve retorike**.

Mungesa e njerëzve më të dashur, në burg të sjell një ngurtësi në shpirt, nuk ke se kujt ti shprehesh dhe të heqësh peshën e të lehtësohesh. Njeriu ka nevojë të bisedojë me dike, qofshin ato edhe hekurat e qelisë. Zhiti e lehtëson këtë peshë, duke bisedur me kalin:

Kam patur edhe unë dëshira të blerta

të njoma si bari.

Ca mi kanë shkelur,

ca i kam mbajtur.

Ty po t'i hedh –

haji!

⁷⁵ Visar Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993, f.47.

Dhe me buzët e thara

mërmërita ngadalë

siç mërmëritet nëpër dashurira:

Kalë, o kalë ...⁷⁶

Dëshirat, ëndrrat e planet si të realizohen në një vend të mbyllur? Poetit i ka humbur shpresa për ti realizur dëshirat sepse ato i janë robëruar dhe si shpërblim për kalin “bashkëbisedues” ia dhuron ato, ti gëzojë në lirinë e tij. Në përshkrimin për veten dhe dëshirat përdor figurën e **epitetit dhe krahasimit**

“Tri rënkime në ajër”

Nga titulli “Tri rënkime” shohim një ndarje tripjesëshe të një zëri të përvuajtur që vazhdimisht kërkon lirinë, ambientin e jashtëm.

i pari:

Faleminderit, o Zot,

që na dhe rënkimet

... për t’u qetësuar...

Dhëmbja bëhet më e bukur.

Të duket vetja zog

mes puplave të trupit.⁷⁷

⁷⁶ Visar Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993, f.48.

⁷⁷ Visar Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993, f.61.

Zëri i parë, (mëngjesi) është një falënderim ndaj Zotit që ekziston një mënyrë për tu shprehur, për tu ndjerë i lirë mes rëndesës së trupit që i ka shkaktuar robëria (burgosja me vite). Por kjo lutje nuk është për diçka të bukur por megjithatë arrin një qetësi. Në këto vargje kemi figurën e **paradoksit**, një kontrast i falënderimit. Në vargjet e fundit përdor figurën e **metaforës** – dhimbja nuk mund të shihet me sy por është ndjenjë shpirtërore e brendshme. Zogun, e përdor si **simbol** të lirisë, ëndrrave por puplat e rënda i'a kanë pamundësuar fluturimin.

i dyti:

Ajër,

ajër ,

ajër! Kujtona, o ajër!

Kemi mbetur pa qiellin,

na u zu fryma.⁷⁸

Zëri i dytë, (mesdita) është një thirrje ajrit, që e kërkon me aq ngulm hapësirën e jashtme apo lirinë. Përmes përsëritjes së fjalës ajër tregon peshën e tij. Këtë përsëritje e shpreh me anë të figurës së **anadorës**. Po ashtu, duke iu drejtuar ajrit, lirisë që ta kujtojë të burgosurin- **apostrofa**. Pjesa e fundit e vargut përmbyllet me **metaforë** – Poeti ka nevojë për një liri të shpirtit dhe trupit.

vajtım:

Vajtoj këtë ditë të sëmurë

që bie si një copë e kalbur

nga trupi i atdheut.

Ku ikim kështu

si një funeral i trembur

⁷⁸ Visar Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993, f.61-62.

*pas arkivoleve të ajrit që u ngjajnë reve.*⁷⁹

Zëri i tretë, (nata) vajton edhe një ditë të humbur, i mbyllur, në pamundësi që të realizojë diçka, e quan veten të kalbur, të padobishëm për atdheun. Këto vargje ndërtohen përmes figurës së **metaforës**. Pjesa e dytë e vargut hapet me një **pyetje retorike**- një ikje nga një realitet i hidhur. Funerali i trembur paraqet një frikë dhe vdekje, ndersa arkivolet e ajrit janë ndjenjat shpirtërore, të pasigurta edhe në vdekje, ideale të mjegullta- **figura e metaforës**.

Mbyllja e njeriut, burgosja të ndalon shumë gjëra por një gjë e cila vazhdimisht ikën është koha, ndërrimi i viteve e pamundësia për ta ndryshuar atë, për ta ndalur. Këtë element, Zhiti e paraqet në këto vargje:

“Koha”

se si më rrëshqet nëpër gishta

pa ma vënë unazën e saj

*dhe unë mbetem veç i dashuruari.*⁸⁰

Koha, e cila përmendet vetëm në titull dhe pastaj në vargje paraqitet lëvizshmëria (ikja) e saj. Autori në pamundësi të shfrytëzimit të kohës, vazhdimisht kërkon që të ketë një mundësi për t’i realizuar planet e tij, por është i mbyllur. Unaza, **simbolizon** një lidhje, një bashkim me lirinë, por kjo gjë nuk i vie, megjithatë ai nuk ndalon së dashuri atë.. Figura stilistike e përdorur është **metafora** – “rrëshqet nëpër gishta”, **epiteti** - i dashuruari.

Nata, në shumë poezi të burgut përdoret për të shprehur ndjenjat e ftohta që krijoheshin nga gjendja e burgut:

⁷⁹ Visar Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993, f.62.

⁸⁰ Visar Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993, f.3.

Natë burgu

së prapthi, e gjatë, e gjatë

Dhe prapë na futin në një natë tjetër,

në natën prej guri, pa agime, të egër.

Natë brenda natës –

Shpellë e llahtarshme:

*Trembesh nga vetja jote fantazmë.*⁸¹

Këto vargje paraqesin një gjendje të mbyllur, një botë të përmbysur, një botë ku koha mbetet e palëvizshme, një natë që nuk mbaron fare. I burgosuri është i pafuqishëm, nuk ka shpresa fare për të ndryshuar, sado mendon mbarimin e një vuajtje, prapë i fillon tjetra. Nata, jo vetëm një errësirë por e ftohtë, armiqësore, pa fund. Vargjet fillojnë me përdorimin e **epiteteve**: e gjatë, e gjatë.. etj. Duke vazhduar me një **metaforë** të fuqishme duke e bërë natën të ngurtë, me një errësirë absolute (natë prej guri, pa agime...). Pastaj vargjet përmbyllëse: Nga nata e vështirë për tu përballur kalon në frikë, kjo, jo frikë e hapësirës së jashtme por asaj të brendshme nga vet-vetja që është kthyer në një qenie të huaj, ndërtohen po ashtu përmes figurës së **metaforës**.

Robëria individuale dhe ajo kolektive, njëri- tjetri apo thënë figurativisht *bashkësia*. Visar Zhiti, këtë term e paraqet në njëren poezi. Secili nga të burgosurit barte atë peshën/ ndjenjën e të qenit i robëruar edhe pse ishin të ndryshëm në pamje apo në moshë, të përbashkët e kishin robërinë:

* * *

Një copë burg

⁸¹ Visar Zhiti, *Dyert e gjalla*, Eurolindja, Tiranë, 1995, f.34.

jam për tjetrin

dhe gjithë të tjerët

për mua janë burgu

rob mbajmë veten.⁸²

Poeti e sheh veten si një pengesë për të tjerët dhe gjithashtu ata që e rrethojnë janë burg për të. Ata e rrisin këtë fakt përmes gjykimeve, pasigurisë, frikës, ndjenjave të brendshme... Përmes figurës së **metaforës** shprehet pavlefshmëria, pamundësia e njëri-tjetrit për të ndryshuar gjendjen e të qenit rob. **Paradoksi** është figura qendrore e këtyre vargjeve: Një cope burg jam për tjetrin dhe gjithë të tjerët për mua janë burgu. Në fund të vargut kemi një **ironi të hidhur**: rob mbajmë veten.

2.2.7 Merxhan Avdyli

Poezia e Merxhan Avdyilit, cilësohet si njëra nga më të bukurat në lirikën e shkruar në burg. Idetë e poezisë së tij krijojnë një botë të re të shprehjeve. Brenda burgut, shprehjet janë diversitet, por lirinë dhe robërinë autori e spikat me ngjyrat më të forta.

Për poezinë e Merxhan Avdyilit, shkruan Bajram Kosumi:

“Robëria si forma më e egër e të qenësuarit, ndihet në çdo varg të Merxhanit, por jo si përshkrim, por si refuzim moral, filozofik e fizik, si mospranim dhe, siç u tha edhe në fillim, si tejkalim përmes krijimit, pa qoftë ky krijim edhe vetëm një mendim, edhe vetëm një dëshirë.”⁸³
Shembulli më i mirë janë këto vargje të poezisë “Dëshirë”:

Prapë më vjen dëshirë e dhezur

⁸² Visar Zhiti, *Dyert e gjalla*, Eurolindja, Tiranë, 1995, f.18.

⁸³ Merxhan Avdyli, *Fati i flijuar*, Fjala, Prishtinë, 1994, f.97.

Për ta ndalur rrjedhën e kohës

Atë lëvizshmëri të sekondës jetësore

Për ta përjetuar një pushim të mirë

*Në hapësirën time që koha po ma vret*⁸⁴

Këto vargje të thella dhe filozofike shprehin një dëshirë, një mall nga brendia e shpirtit për të ndryshuar shumë gjëra; e para ndalja e sekondave, minutave, kohës. Autori kërkon një pushim nga presioni i përditshmërisë, kalimi i viteve- plakjes. Secili çast është i rëndësishëm, kërkon një pushim shpirtëror në mes kaosit. Figurë dominante është **metafora** – dëshirë e dhezur , në hapësirën time që koha po ma vret; Kohën e quan armike, vrasëse, tretëse e pamëshirshme.

Duke lexuar tutje poezitë e Merxhan Avdytit, idenë e robërisë e shohim edhe te shumë poezi të tjera si:

“Koha që erdhi”

Ajo erdhi pa dëshirën tonë

Sepse pa ne qe nisur

Ne s’ mund të bartim gjë të saj

*Siç s’ mund të lëmë në të atë që duam*⁸⁵

Kohën në robërim, minutat në burg asnjëherë nuk mund ti kontrollojmë sepse ato nuk levizin sipas dëshirës sonë, ndikimi ynë është zero! Koha është një forcë në vete, ndonjëherë edhe kujtimet që i kemi krijuar nuk mund ti bartim me vete, i mbeten asaj sepse njeriu është i përkohshëm.

“ Duket gjë s’ na ka mbetur

Për të ngrënë nga koha jonë

⁸⁴ Merxhan Avdyli, *Fati i flijuar*, Fjala, Prishtinë, 1994, f.39.

⁸⁵ Merxhan Avdyli, *Fati i flijuar*, Fjala, Prishtinë, 1994, f.19.

Tani mund të hamë vetëm veten

Në këtë kohë që erdhi pa na pyetur

E që nuk e dinim se a do të vinte fare”⁸⁶

Vargjet e lartëpërmendura shprehin ndjenja të errëta dhe shpresa të humbura, sepse “shisheja e kohës” është zbrazur: shpresat, energjia, ushqimi i mendjes e shpirtit. E kur burimet shuhen, koha nuk të dhuron më asgjë, njeriu bie në kundërshtim me veten- ha vetëm veten; figura e **metaforës**. Koha e pushton njeriun, në momentin më të dobët..

Liria, në poezinë e Merxhan Avdyli merr emërtime nga më të veçantat, kështu në njërin nga ato ai e quan veten maratonist, dhe lirinë maratonë, çdo herë duke dashur të afrohet në cak të saj, të jetë i lirë:

“Maratonisti”

As frymë lirisht

Nuk mund të marr

E fitoren e lirisë

Më duhet ta lajmëroj⁸⁷

Maratonisti është dikush që vrapon pa u ndalur- edhe autori është i tillë vrapon pa pushim për të arritur idealin e tij, me shumë vështirësi, i shtypur, i lodhur, por në fund duhet të dal fitimtar sepse asnjëherë nuk duhet të dal humbës para armikut. Figura e përdorur është **paradoksi** – Mezi merr frymë por fitoren duhet ta lajmërojë.

Zogu, njëri nga **simbolet** i cili shpreh lirinë ndërsa kafazi, vendi ku është i mbyllur zogu. Në këtë rast këto dy simbole shprehin mbylljen, burgosjen e autorit. Këtë ai e thotë me vargjet e poezisë së tij :

“Fat”

⁸⁶ Merxhan Avdyli, *Fati i flijuar*, Fjala, Prishtinë, 1994, f.19.

⁸⁷ Merxhan Avdyli, *Fati i flijuar*, Fjala, Prishtinë, 1994, f.14.

Kush ma futi fatin në kafaz?

E më mbylli edhe mua në të,

Bashkë me zogun e zaifët të lirisë,

Për të na mekur nga loja e lodhjes,

Deri në frymën e fundit të jetës,

Që dikush pret të jetë sa më e shkurtër.⁸⁸

Në fillim të poezisë është e përdorur **pyetja retorike**. Fati në kafaz- një jetë me kufizime, një zog i lodhur, pa fuqi të krahëve për të fluturuar, një liri me shpresa të thyera. Jeta brenda burgut çdo ditë është një mbijetesë- luftë e jetës me vdekjen, ky ballafaqim dëshirohet nga të tjerët të jetë i zhdukur.

“Kurse unë dhe zogu i zaifët i lirisë,

E vazhdojmë ritmin e këngës së qëndresës,

Duke pritur kohën që sjell shpëtimin,

Se asnjë fat gjatë në kafaz s’mbahet,

E fati im nga i zogut të lirisë s’ndahet.”⁸⁹

Edhe pse i mbyllur në kafaz asnjëherë nuk e humb shpresën, bëhet një me zogun- bashkim midis shpirtit njerëzor dhe idealit të lirisë. Përmes figurës së **metaforës** – ritmin e këngës së qëndresës- autori zgjedh mënyren paqësore për të përballuar çdo vuajtje. Autori beson thellë se do të jetë i lirë, jo vetëm si dëshirë por është një ideal i pashuar i tij.

⁸⁸ Merxhan Avdyli, Ismail Sylaj, Hydajet Hyseni, Januz Januzaj, Bajram Kosumi, *Libri i lirisë*, Embeta, Prishtinë, 2020, f.27.

⁸⁹ Merxhan Avdyli, Ismail Sylaj, Hydajet Hyseni, Januz Januzaj, Bajram Kosumi, *Libri i lirisë*, Embeta, Prishtinë, 2020, f.27.

2.2.8 Hydajet Hyseni

“Poezia e Hydajet Hysenit, për vetë rrethanat në të cilat është krijuar, është e lidhur ngushtë me burgun. Temat e saj, subjektet, motivet, idetë, lindin në pjesën dërrmuese të rasteve, brenda hapësirës së burgut.”⁹⁰ Ai përdorë termin grilë (burg) si një lajtmotiv në veprën e tij, duke e përdorur në poezi me emërtime të ndryshme por si një fjalë kyçe që e ndërton si tërësi.

“Burg- Grub”

Beograd- burg grand,

Burg central, burg në kub;

Këtu fjala lexohet mbrapsht,

*Fjala burg do të thotë **grub***⁹¹.

Beograd – burg i madh,

Beoburg, burg me rob;

*Beograd – Beo – **gard***⁹²,

*Beo – grub, Beo – **grob***⁹³ .⁹⁴

Kjo poezi është një nga shembujt, në të cilën, Hydajet Hyseni përdorë fjalën burg jo vetëm në kuptime të shumta, por edhe ndjesinë që i ofron ai vend, ku ishte i burgosur, Beogradi. Poezia, në zbërthim ka disa figura stilistike të cilat e bëjnë të veçantë: **aliteracioni**- përsërtije e

⁹⁰ Hydajet Hyseni, *Paraverë në katër pamje (album '81)*, Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë, 2006, f.524.

⁹¹ (serbisht)- I vrazhdë

⁹² Lojë fjalësh. (Serbisht): Beo- I bardhë.

⁹³ Lojë fjalësh. (Serbisht): Grob- varr.

⁹⁴ Hydajet Hyseni, *Paraverë në katër pamje (album '81)*, Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë, 2006, f.260.

bashkëtingëllores *b* dhe *g*, **asonanca**- kemi përsëritjen e zanoreve *e* dhe *o*. **Fjalët e huaja** apo barbarizmat, janë të përdorura si: grub, gard, grob.

“Hydajet Hyseni krijon një nocion të veçantë për poezinë nga burgu: *griliadë*, i cili në interpretim të lirë është ep për burgun (në poezinë Griliadë).”⁹⁵

“Griliadë”

“Syri im sheh shkurt,

Vetëm dy metra me tri,

Se aq është tash bota ime:

-Dy metra me tri!

E më kanë harruar sytë,

Si duken rrezet,

*Si duket qielli ...”*⁹⁶

Këto vargje shprehin një mbyllje ekstreme, izolim të hapsirës fizike dhe ngushtimit shpirtëror. Këto dimensione paraqesin dhomën e burgut ku as shikimi nuk kalon më përtej e as shpirti nuk mund të zgjerohet. “Se aq është bota ime- dy metra me tri”- shprehet një **metonomi** – për ta treguar se si i është ngushtuar bota. Sytë arrijnë të mbajnë gjallë kujtimin por brenda burgut kanë harruar- kjo paraqet një **metaforë** – harresë për botën e jashtme, proceset natyrore.

Idenë e lirisë, Hydajet Hyseni e paraqet në këto vargje:

“Bimë e pashkulshme”

⁹⁵ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.198.

⁹⁶ Hydajet Hyseni, *Paraverë në katër pamje (album '81)*, Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë, 2006, f.351-352-353.

“Më kotë gërmon në zemrën time, oficer,

S’e shkul dot afshin e lirisë,

Eshte mbjellë ai atje,

Që kur jam ushqyer për kërthizë;”⁹⁷

Bimë e pashkulshme - e pamundur për t’u zhdukur, kjo bimë paraqet një ndjesi, një forcë që vjen nga brenda për lirinë pavarësisht përpjekjeve për tu asgjësuar nga kontrolli e dhuna. Oficeri bën të pamundurën, për ti kontrolluar ndjenjat e mendimet e të burgosurit por vrullin e brendshëm nuk mund ta shuan: Liria është e ngjizur për gjaku që nga lindja. Figura dominante është **metafora**.

Bashkë me ajrin, ujin, bukën...

e lëngun e qershisë...

O s’e shkul atë bimë,

Për pa e shkukur zemrën,

*Se është mbjellë në ç’do **por** të saj,*

*Në çdo **damar**,*

*Në çdo **ind**,*

*Në çdo **qelizë**.⁹⁸*

Elementet esenciale për jetë ajri, uji, buka- duke i përmenduar këto autori tregon se edhe liria është aq parësore si këto. Për ta hequr dëshirën për liri duhet shkukur zemrën. Vargjet kanë në përbërje figurën e **metaforës** – O s’e shkul atë bimë për pa e shkukur zemrën- Liria rritet natyrshëm në shpirt, këtë e forcon edhe përdorimi i **pasthirmës O**. Vargjet i bënë më

⁹⁷ Hydajet Hyseni, *Paraverë në katër pamje (album ’81)*, Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë, 2006, f.212.

⁹⁸ Hydajet Hyseni, *Paraverë në katër pamje (album ’81)*, Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë, 2006, f.212.

interesante edhe dominimi i figurës së **paralelizmit figurativ**- është mbjellë në ç’do por, damar...

2.2.9 Rasim Selmanaj

“Burgu në përgjithësi e ai serb në veçanti nënkupton vendin e ngushtimit maksimal të hapësirës jetësore dhe ndaljen e kohës aktive të jetës njerëzore, të dhunës së gjithanëshme mbi njeriun shqiptar e në këtë kontekst edhe mbi subjektin lirik.”⁹⁹ Por, i burgusori edhe pse ndodhet brenda kësaj hapësire, prapë e gjen një refuzim kundër mbylljes në tërësi, e ky refuzim është poezia: “Poezia dritare e hapur në muret e burgut”¹⁰⁰ Këtë dritare, ai e tregon në shprehjen e vargjeve:

“Harroj për një çast”

“ Harroj për një çast se jam zog shtegtar i zënë

Befas në kafas,

Kënaqem duke kuvenduar me gjurmët e rinisë

në kujtime.”

Çasti, ndonjëherë të dhuron diçka krejt të kundërt nga gjendja e vërtetë. Në këtë rast, autori kujton kohën e rinisë së tij, lirinë. Kujtimet, zakonisht na sjellin ndjenja nostalgjike, lumturie dhe si rrjedhojë e shijon atë çast dhe harron të keqen, robërinë. Në fillim të vargjeve, shprehet një **antitezë** : nga një zog fluturues kalon në kafas. Për kujtimet e rinisë e përdor figurën e **metonomisë**: gjurmët. Përpos kënaqësisë, kujtimet sjellin edhe mërzi e mall për atë kohë, një pritje të gjatë, duke e përdorur **metaforën** në vargjet:

“ Malli ma mbulon zemrën time të bërë copë e grimë,

⁹⁹ Rasim Selmanaj, *Shtegtar i Lirisë*, Brezi 81, Prishtinë, 2001, f.6.

¹⁰⁰ Rasim Selmanaj, *Shtegtar i Lirisë*, Brezi 81, Prishtinë, 2001, f.5.

Liqeni që s' shëron, qiellit tim i dhuron kanjusha

e kaltërsi,”

Por, autori gjen një shërim për gjendjen e tij, e ky është shkrimi i poezisë, siç e quan “*dritare e hapur*” :

“Me lapsin tim nis të gdhend- vargje shëruese

me rimë .”¹⁰¹

Të burgosurit asnjëherë nuk e pranonin veten si të tillë, ata gjithmonë e konsideronin veten një udhëtar, një shtegëtar drejt rrugës së lirisë. Një shembull është poezia:

“Rrugëtim”

“Shtegëtar i etur për pak dritë

Dallgëve të jetës që përplaseshin...

Mundimshëm rrugëve

Endej jeta ime”

Shtegëtari- është një simbol i njeriut që gjithmonë është në kërkim të shpresës, qetësisë së brendshme, lirisë edhe pse rrugën e kishte të trazuar me plot sfida e vështirësi, duke u endur si një i humbur. Figura stilistike e përdorur është **metafora**.

“Yjet nuk fikeshin

Digjeshin shëndritnin si fanar

Bilbilat vazhdonin këngën

Lundër e shpresës sime

¹⁰¹ Rasim Selmanaj, *Shtegtar i Lirisë*, Brezi 81, Prishtinë, 2001, f.12.

Ëndërr e bleruar.”¹⁰²

Përkundër vështirësive, prapë rruga e poetit është e ndriçuar me dritë brenda errësirës dhe kënga e bilbilave nuk ndalet, shpresë e lirisë. Ai gjen mjetin e shpëtimit për të arritur deri tek ëndrra, gjelbërimi, jeta e re. Disa nga figurat stilistike të përdorura në këto vargje janë: **krahasimi** – yjet digjeshin si fanar; **metafora** – lundër e shpresës sime; **epiteti** - e bleruar.

“Burgu”

“Burgu këtë herë

Ka nis të qëndis larushi ngjyrash

Livadhi im dikur plot gjelbërim

S’ngjan më në pranverë të vrullshme.”¹⁰³

Burgu- një vend i errët ku autori qëndron i mbyllur por në këto vargje ky realitet nis të “zbukurohet” të vishet me disa ngjyra mashtruese por robëria nuk zhduket. Të kaluarën e kishte në kujtime, një rrjedhshmëri të natyrshme jete por më nuk ishte e tillë. Vargjet fillojnë me figurën e **metaforës** duke vazhduar me **kontrastin**- gjelbërimi kthehet në thatësi.

2.2.10 Besim Zymberi

Poezia e Besim Zymberit është e lidhur ngushtë me vendlindjen e tij, me përpjekjet për t’i bërë ballë vështirësive, për të mos u nënshtuar asnjëherë burgut si hapësirë dhe si gjendje. Rugën e qëllimin drejt lirisë e shpreh në vargjet e poezisë. Besim Zymberi poezinë e tij e përkufizon në këtë mënyrë: “ Në poezinë time populli bën luftën, në shpirtin tim nuk kanë vend iluzionet”.¹⁰⁴ Duke e kuptuar kështu si një mosdorëzim ose thënë ndryshe shprehja e shpirtit në poezi e mund

¹⁰² Rasim Selmanaj, *Shtegtar i Lirisë*, Brezi 81, Prishtinë, 2001, f.13.

¹⁰³ Rasim Selmanaj, *Shtegtar i Lirisë*, Brezi 81, Prishtinë, 2001, f.53.

¹⁰⁴ Besim Zymberi, *Perëndia qan nën Shqipërinë*, Botimet Dritëro, Tiranë, 1999, f.97.

burgun, robërinë. Perceptimi i lirisë, nuk është vetëm kaq, është i vertetë dhe ajo ditë do të ndodhë:

“Lirisë”

“ Ti ikën posi lumi që gjarpëron mes malesh.

Ikën ti, e unë s’ shoh gjë tjetër veç hijes sate,

Vrapoj pas teje pa ditur se ku do të ndalesh,

S’e dua jetën në ankth, në terrin e kësaj nate.” ¹⁰⁵

Liria, si ide shprehet në forma të ndryshme, një nga këto është me përshkrimin e natyrës, në këtë poezi autori e shpreh me anë të rrjedhshmërisë së lumit, duke e **personifikuar** si një qenie që lëviz, e cila nuk mund të matet me sy njeriu, por lumi po ashtu **simbolizon** rrjedhën e jetës, një **krahasim**: ti ikën posi lumi që gjarpëron mes malesh - malet paraqesin një pengesë, hija- një ndjesi humbjeje, poeti nuk e di se sa do të presë derisa të jetë i lirë.

“ I fortë do të jem të të ndjek deri sa të arrij,

Kokën do t’ia shtyp urithit që s’do shkëndijë drite.

Në agimin e bardhë që së shpejti do të vijë,

Liri!- Me këngë do të presim gëzimin e asaj dite.” ¹⁰⁶

Përkundër vështirësive dhe përpjekjeve të armikut për të shuar dritën e lirisë nuk ndodh asnjëherë të humb shpresa, sepse autori është i bindur që do ta gëzojë atë ditë e do ti këndojë këngë.

Figura stilistike, **metafora** është prezente te: Kokën do t’ia shtyp urithit që s’do shkëndijë drite.

Agimi i bardhë **simbolizon** një shpresë, një ndryshim të ri.

¹⁰⁵ Besim Zymeri, *Perëndia qan nën Shqipërinë*, Botimet Dritëro, Tiranë, 1999, f.79.

¹⁰⁶ Besim Zymeri, *Perëndia qan nën Shqipërinë*, Botimet Dritëro, Tiranë, 1999, f.79.

Kapitulli III

3. Shenja në poezitë e burgut

Në letërsi, çdo vepër është një raport mes autorit, tekstit dhe lexuesit. Lexuesi është bërthamë, e cila mund të lëviz nga një vepër në tjetrën dhe e ka fuqinë të dallojë apo të njëjtësoj elementet që e përbëjnë atë. Së pari, zhanri i poezisë është më e përbashkëta nga autorët e burgut. Duke qenë në burg, të gjithë nga këta autorë janë përballur me situata të ndryshme, ajo më e vështira ka qenë lufta ekzistenciale-ballafaqimi i jetës me vdekjen. Kur flasim për shkrimin e poezisë, poezia, në radhë të parë është krijuar në kushte të jashtëzakonshme, në kushte burgu.

“ Kjo lirikë është krijuar prej poetëve të cilët kanë pasur, kush më shumë e kush më pak, të njëjtin fat jetësor kanë burguar. Ky fakt jetësor ka paracaktuar edhe disa rrethana të njëjta të komunikimit të tyre me jetën, të literaturës së lexuar, të diskutimit të çështjeve të njëjta, po edhe të disa situatave jetësore të njëjta që kanë ndikuar në përjetimin dhe krijimin e disa ndjenjave përafërsisht të njëjta, si p.sh përballimi i dhunës si shfaqje e skajshme politike dhe antihumane, vetë ballafaqimi me këtë antihumanizëm, malli për atdheun e për familjen, dashuria në largësi ndaj femrës etj. Këto situata jetësore të afërta kanë ndikuar fuqishëm edhe në verbin e tyre poetik, sepse lirika, fundja, sikurse krejt letërsia, është një botë e re (fiktive) e krijuar nga individi i cili, sado që është i ndryshëm, vetë është prodhim i botës ekzistuese (reale) dhe e bartë botë me vete si lëkurën e vet.” ¹⁰⁷

¹⁰⁷ Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu/ kapitull më vete në letërsinë shqipe- botim i përpunuar*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020, f.113.

Duke i parë të gjitha këto elemente në poezitë e burgut, ne jemi ndalur më shumë te literatura e lexuar apo diskutimi i çështjeve të njëjta, një nga këto ka qenë përdorimi i figurave apo miteve greke si simbole apo figura për poezinë e tyre.

3.1 Intertekstualiteti në poezinë nga burgu

Duke e ditur se poezia nga burgu përmban edhe elemente postmoderne, atëherë mund të ndalemi tek një element i postmodernizmit, pikërisht tek intertekstualiteti: “ Intertekstualiteti është përkufizuar si prani e një teksti brenda një teksti tjetër.”¹⁰⁸ “ Postmoderna është art i vetëdijshëm “brenda arkivit” (Foucault 1977, 92), kurse ky arkiv është edhe historik, edhe letrar. Ta parodizosh të shkuarën, nuk domethënë ta shkatërrosh atë; në të vërtetë, përkundrazi, kjo do të thotë ta bësh të shkuarën të shenjtë, por edhe ta kontestosh atë. “¹⁰⁹ Mbi këtë përkufizim, mund të theksojmë se autorët e letërsisë së burgut në poezinë e tyre kanë futur figura nga letërsia dhe mitet greke . Disa nga figurat e miteve greke të cilat autorët e burgut kanë përdorur në poezitë e tyre janë:

Anteu- “ i biri i Poseidonit, zotit të detit dhe hyjneshës së tokës Gea, gjigant i fuqisë së papërballueshme. Secili që vinte në tokën e tij e detyronte që të luftojë me të, në këtë dyluftim e mundte kundërshtarin dhe e vriste pamëshirë.”¹¹⁰ Këtë figurë e ka përdorur në poezi:

- **Hydajet Hyseni-** Njëren poezi ai e titullon “*Anteu im i ri*”:

Ai përleshej zgjidhur,

Ti i lidhur nën dry;

¹⁰⁸ <https://bajramkosumi.com/wp-content/uploads/2023/11/Fishta-intertekstual.pdf>

¹⁰⁹ Linda Hutcheon, *Poetika e postmodernizmit*, OM, Prishtinë, 2013, f.179.

¹¹⁰ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Anteu>

Ku e gjen atë forcë,

Anteu im i ri!?

Ai prekte tokën nënë,

Ti s'e sheh me sy;

Nga e merr atë forcë,

Anteu im i ri!? ¹¹¹

Anteu, si simbol i qëndresës. Autori e përdor këtë figurë për të treguar përballjen me burgun, fuqinë që e krijonte nga vetëvetja edhe pse ishte i mbyllur e nuk e shihte tokën dot.

Prometeu- “Prometeu i takon simbolit të luftës më të hershme, por përherë të re për përparimin dhe lumturinë e njerëzimit. Nga zjarri i shenjtë në Olimp (sipas versionit tjetër nga furra e zotit Hefest në malin Moshil, në ujedhesën Lemnos e vodhi zjarrin dhe ua dha njerëzve. Me përvetësimin e këtij elementi, njerëzit filluan të jetojnë me një jetë të vetëdijshme dhe të arsyeshme. E kuptuan se zjarri është jo vetëm zotëri, por edhe shërbëtor i mirë, u bënë të pavarur nga teket e natyrës, e përgatitnin ushqimin e bollshëm dhe u forcuan fizikisht e shpirtërisht.” ¹¹²

- **Avdush Canaj-** Ai e titullon njëren nga poezitë e tij: “*Vëllezër të Prometeut*” :

Ata godit e godit

Ne gojëkyçur.

Të lidhur durojmë

Njëri bëri me gisht,

Janë vëllezër të Prometeut

¹¹¹ Hydajet Hyseni, *Paraverë në katër pamje (album '81), Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës*, Prishtinë, 2006, f.259.

¹¹² <https://sq.wikipedia.org/wiki/Prometeu>

Këto vargje shprehin një shtypje, një dhunë, mbi një turmë njerëzish që përballojnë edhe pse vazhdimisht goditen. Janë vëllezër të Prometeut- vuajnë me dinjitet, heronjë që sakrifikohen për të arritur idealin, të mirën, të vërtetën.

- **Kasëm Trebeshina-** Trebeshina e emëron njëren poezi: **“Prometeu”**

Sërish kthen kokën tej nga deti:

lart në Olimp një zjarr ndriçon!...

Përposh rreth zjarrit ishin njerëzit:

një zjarr nga tjetri nuk ndryshon!...

Dhe Prometeu hesht i qetë

*mushkrit kur shqipja i copton!*¹¹⁴

Në mitologji, Olimpi ishte vendbanimi i perëndive- këto vargje shprehin dallimin mes fuqisë hyjnore dhe asaj njerëzore por që të përbashkët kishin zjarrin, edhe pse Prometeu dënohet që vodhi zjarrin, ai duron sepse u dha njerëzve atë që perënditë e mohanin, pra u sakrifikua. Ashtu edhe poeti përballon forcat e jashtme për të arritur lirinë.

- **Ismail Syla-** Ismail Syla në poezinë e tij e përdor : **“Antiprometeu”** ;

Të thyer njeriun e deshën antiprometetë

Të zhdukur si popujt në Librin e Shenjtë

¹¹³ Avdush Canaj, *Edhe ëndrrat në pranga(Lirika nga burgu)*, Armagedoni, Prishtinë, 2022, f.67.

¹¹⁴ Kasëm Trebeshina, *Polimnia dhe Melpomena I*, Faik Konica, Prishtinë, 2006, f.44.

Të tretur si hëna, të fikur, meit në fytyrë,

*Të shurdhuar, të heshtur si antikënga.*¹¹⁵

Prometeu sjellë dritë, shpresë. Antiprometeu (Kundërprometeu) sjell ndëshkim, errësirë- Këto vargje shprehin një kundërshtim me botën njerëzore, mungesë jete, shprese, moskomunikim, një heshtje në shpirt, në krijim, në liri, në poezi...

Homeri - Odiseu (Uliksi) “Një luftëtar dinak dhe i aftë, Odiseu ishte mbreti i Itakës. Aktet heroike të tija në Luftën e Trojës u dokumentuan nga Homeri në “Iliadën” dhe më tej në “Odisenë” e tij, e cila përshkruan luftën 10-vjeçare të Odiseut për t’u kthyer në shtëpi. Gjatë asaj kohe, Odiseu dhe njerëzit e tij u përballën me sfida të shumta, duke përfshirë rrëmbimin nga një ciklop, tundimin nga sirenat dhe më në fund fundosja e anijes. Odiseu mbijeton i vetëm, për t’u përballur me prova shtesë para se të kthehej përfundimisht në shtëpi.”¹¹⁶ Këtë figurë e përdorë në poezinë e tij:

- **Visar Zhiti - “Në detin e Homerit”**

“ Shkoj shpesh

buzë detit

dhe hedh këpucët në ujë.

Nuk e di si ndodh

Po ja që këpucët e mia

zmadhohen e zmadhohen

*e bëhen anije për të kthyer Uliksat në shtëpira.”*¹¹⁷

¹¹⁵ Ismail Sylaj, *Tempulli i braktisur*, Rilindja, Prishtinë, 1998, f.11.

¹¹⁶ <https://filozoficdodite511027287.wordpress.com/2020/11/02/7-heronjte-me-te-medhenj-te-mitologjise-greke/>

¹¹⁷ Visar Zhiti, *Kujtesa e ajrit*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993, f.37

Këto vargje paraqesin një simbolikë të thellë ku autori e krahason veten me një nga figurat më të njohura të Homerit, Uliksin (Odiseun). Ai e paraqet veten si një udhëtar në një pafundësi me të panjohura të jetës, me mall për kohën e shkuar. Mendimet, ndjenjat i zmadhohen vazhdimisht por prapë e ka shpresën për të rigjetur shtëpinë, paqen, ngrohtësinë dhe për ta pëfunduar këtë udhëtim, ashtu si Odiseu, i rikthyer.

Zeusi- “ ishte i biri i Kronosit dhe Reas, ishte sunduesi i qiellit dhe tokës, babai i njerëzve dhe Zotave tjerë. Konsiderohet si pari, më i madhi dhe i pavdekshmi nga të gjithë Zotat tjerë të OLIMPIT. Arma e tij ka qenë rrëfeja, ndërsa pushteti i sundimi toka dhe qielli.” ¹¹⁸

- **Bajram Kosumi - “Lutja e fundit drejtuar Zeusit”**

“ O zot i qiellit

Sundimtar i tokës dhe njerëzimit

Më lejo mua, robin tënd

Ta bëj lutjen e fundit

Për ta shpëtuar veten e njerëzimin nga shkatërrimi. ”¹¹⁹

Lutja në këto vargje nuk është thjeshtë një lutje individuale, por një lutje që përpiket ta shpëtojë botën, njerëzimin duke iu drejtuar një fuqie që ka në dorë gjithçka, Zeusit (mbretit të perëndive). Kjo në anën tjetër shpreh një lloj sakrifice. Lutja e fundit- rrënimi i botës - por ende ekziston shpresa e shpëtimit.

¹¹⁸ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Zeusi>

¹¹⁹ Bajram Kosumi, *Fjalor i barbarëve, Brezi 91*, Prishtinë, 2000,(botim i dytë 2010), f. 111.

Miti i Pandorës- “ është një lloj teodiceje, duke trajtuar pyetjen se pse ekziston e keqja në botë. Sipas kësaj, Pandora hapi një kuti (pithos), duke lëshuar të gjitha të këqijat e njerëzimit, e që në rrëfimet moderne ndonjëherë trajtohet si "Kutia e Pandorës".” ¹²⁰

- **Merxhan Avdyli – “Pandora”**

*E sheh se sa e vrazhdë është koha
Kjo kohë që plas përplas gjithçka
E si mund të ruhet koka jote kryeneçe
Beso në pabesinë time të shpifur Pandora
Jam i lumtur për thyerjen e gjërave
Në rrethin e vërtetë të fatit tone
Se liria ka filluar të lahet në lumë
Në lumin e gjatë të jetës sonë të shkurtër* ¹²¹

Në këto vargje autori tregon forcën e kohës në mënyrë metaforike, si një shkatërruese të gjithçkaje. Duke e marrë për simbol Pandorën, pra sipas mitit grek, ajo hap kutinë dhe i shpërndan të gjitha të këqijat- ashtu edhe jeta e poetit është e mbushur me zhgënjime, dhimbje dhe këto i krijojnë një jetë të pafundme- momentet e vështira duket sikur zgjasin përgjithmonë. Lirinë, e quan të ndotur por beson në pastrimin e saj.

Përfundim

¹²⁰ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Pandora>

¹²¹ Merxhan Avdyli, *Fati i flijuar*, Fjala, Prishtinë, 1994, f.45.

Qëllimi kryesor i këtij punimi ishte interpretimi i mundshëm i një poezie nga burgu me tematikë; lirinë dhe robërinë, për nxënësit e shkollave të mesme të larta. Duke e parë se gjatë leximit të poezisë ata ballafaqohen me vështirësi në kuptimim dhe interpretimin e saj, ndaj, u përcaktuam për këtë studim dhe kjo analizë e bërë, synon të ofrojë një kuptim më të thelluar të saj. Shkrimi i poezisë nga autorët e burgut nuk ishte vetëm një akt fizik por një çlirim mendjeje e shpirti.

Nga interpretimet e poezive të përzgjedhura pamë se; robëria në poezinë nga burgu, burgosja apo robëria fizike është e kufizuar por nuk arrin ta thyen shpirtin e një njeriu të vetëdijshëm dhe të bindur në të drejtën e tij; liria në poezinë nga burgu nuk është vetëm fizike, është liri e mendjes, e ndërgjegjjes dhe idealeve, dhe kjo liri është e pathyeshme edhe në kushtet më të vështira, ndërsa nga analizat stilistike tregohet një ligjërim me shumëllojshmëri figurash, e si rezultat e bën poezinë nga burgu dhe, përgjithësisht poezinë tonë të pasur.

Ndonëse, që nga lindja e letërsisë shqipe, temat si liria dhe robëria janë të njohura por në poezinë nga burgu paraqesin një risi, kjo për arsye se ndërtohen me simbole të reja, figura, gjuhë të pastër, nuk përmbajnë urrejtje, përcjellin mesazhe të vlefshme si: forcojnë ndjenjën e qëndresës dhe vetëbesimit, liria nuk qëndron vetëm në trup por në mendje, etj. Këto, jo vetëm që ndikojnë në edukimin estetik e humanist por edhe në perceptimin dhe ndjesinë më të mirë ndaj poezisë, si zhanër dhe si mjet për mësimdhënie.

Si përfundim, ky studim dëshmoi se poezitë nga burgu me dy idetë poetike; lirinë dhe robërinë janë të rëndësishme për tu interpretuar në procesin mësimor sepse ndihmojnë në zbërthimin dhe kuptimin letrar, shprehjen emocionale dhe për vetë faktin se poezia është ndjenjë, krijon një ndjeshmëri shpirtërore.

Bibliografia dhe literatura

Literatura bazë:

Pipa, Arshi, ***Libri i Burgut***, (botim i dytë), Rilindja, Tiranë, 1994.

Kosumi, Bajram, ***Fjalor i barbarëve***, Brezi 91, Prishtinë, 2000, (botim i dytë 2010).

Treleshina, Kasëm, ***Polimnia dhe Melpomena 1***, Faik Konica, Prishtinë, 2006.

Avdyli, Merxhan, Sylaj, Ismail, Hyseni, Hydajet, Januzaj, Januz, Kosumi, Bajram, ***Libri i lirisë***, Embeta, Prishtinë, 2020.

Avdyli, Merxhan, ***Fati i flijuar***, Fjala, Prishtinë, 1994.

Zhiti, Visar, ***Dyert e gjalla***, Eurolindja, Tiranë, 1995.

Zhiti, Visar, ***Kujtesa e ajrit***, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993.

Hyseni, Hydajet, ***Paraverë në katër pamje*** (album '81), Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë, 2006.

Sylaj, Ismail, ***Tempulli i braktisur***, Rilindja, Prishtinë, 1998.

Canaj, Avdush, ***Edhe ëndrrat në pranga (Lirika nga burgu)***, Armagedoni, Prishtinë, 2022.

Selmanaj, Rasim, ***Shtegtar i Lirisë***, Brezi 81, Prishtinë, 2001.

Zymberi, Besim, ***Perëndia qan nën Shqipërinë***, Botimet Dritëro, Tiranë, 1999.

Literatura ndihmëse teorike:

Aristoteli, ***Poetika***, Albas, Tiranë, 2023,

Zhiti, Visar, ***Kartela të realizmit të dënuar dhe panteoni i nëndheshëm***- sprovë pas burgut për të tjerët dhe veten, Uegen, Tiranë, 2020.

Kosumi, Bajram, ***Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe***-botim i përpunuar, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve në Shkup, 2020.

Kosumi, Bajram, ***Enciklopedia imagjinare-postroman***, Artini, Prishtinë, Toena, Tiranë, 2023.

Solar, Milivoj, ***Teoria e letërsisë***, Rilindja, Prishtinë, 1928.

Wellek, Rene, Warren, Austin, ***Teoria e letërsisë***, Onufri.

Rahmani, Zejnullah, ***Teoria e letërsisë***- botim i dytë i plotësuar, Faik Konica, Prishtinë, 2008.

Hutcheon, Linda, *Poetika e postmodernizmit*, OM, Prishtinë, 2013

Dykro, Osvald, Todorov, Cvetan, *Fjalor i shkencave të ligjërit*, përkthyer nga Dr. Rexhep Ismajli, Rilindja, Prishtinë, 1984.

Qosja, Rexhep, *Tri mënyra të shkrimit shqip*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004.

Zhiti, Visar, *Panteoni i nëndheshëm ose letërsia e dënuar*, OMSCA-1, Tiranë, 2010.

Hamiti, Sabri, *Tematologjia*, ASHAK, Prishtinë, 2005.

Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*

Burime nga interneti:

<https://bajramkosumi.com/index.php/2023/12/12/poezia-e-bajram-kosumit/>

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Zeusi>

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Pandora>

<https://filozofcdodite511027287.wordpress.com/2020/11/02/7-heronjte-me-te-medhenj-te-mitologjise-greke/>

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Prometeu>

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Anteu>

<https://bajramkosumi.com/wp-content/uploads/2023/11/Fishta-intertekstual.pdf>